



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik
Kuvendi i Komunës
-Kryesuesi i Kuvendit-

01Nr. 60/01-27946/2022
Kaçanik, 17.10.2022

FTESË PËR MBLEDHJE

Të nderuar Anëtarë të Kuvendit të Komunës,

Në bazë të nenit 43 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, e thërras mbledhjen e X (dhjetë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2022.

Mbledhja do të mbahet në sallën e kuvendit të komunës, në katin e tretë të objektit të komunës, me 26 tetor 2022 (e Mërkurë) në ora 11:00.

Mbledhjen do ta kryeson dhe udhëheq Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.

Ju mirëpresim!

Me respekt!

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli

Në mbledhjen e Kuvendit të Komunës të datës 26.10.2022, do të shqyrtohet ky:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e kuvendit të komunës;
2. Raporti financiar për periudhën: Janar-Shtator 2022;
3. Propozim Vendimi caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2023;
4. Plani i Veprimit për parandalimin e dhunës në familje, 2023-2025;
5. Informatë për fillimin e Vitit të Ri shkollor 2022/2023;
6. Informatë për përfundimin e Vitit shkollor 2021/2022;
7. Propozim Vendimi për realizimin e një vizite studimore e Kuvendit të Komunës Kaçanik në Republikën e Shqipërisë;
8. Propozim Vendimi për transfer të mjeteve sipas buxhetit të vitit 2022.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal of Kaçanik

01Nr. 60/01-25557/22
Kaçanik, 29.09.2022

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **IX (nëntë)** e rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2022 (Legjislatura e shtatë), mbajtur me 29 shtator 2022. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje ishin fillimisht 24 anëtarë, ndërkaq gjatë shqyrtimit të pikës 2 erdhi anëtarja Arlinda Rakoci-Raka, kështu që konstatohet se pjesëmarrës të mbledhjes ishin 25 anëtarë. Në mbledhje munguan me arsye, Bashkim Luma, pa arsye Besnik Salihu.

Prej ekzekutivit të komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Nënkryetari i Komunës- Sabedin Vishi, Drejtorët e drejtorive: Qamil Stagova- DUKMM, Bahri Selimi-DBF, Sali Malsiu-DSHMS, Ramadush Osmani, Suad Dullovi- DBPZHR, Dardana Tafili-Dauti- DAP, Hafize Sallahu, ndërkaq nga zyrtarët e komunës: Fatlume Guri-Selimi dhe Arbnora Kuka.

Nga strukturat vendore mbledhja monitorohet përmes Teleprezencës nga Gëzim Sahiti- zyrtar i lartë për monitorim të komunave në MAPL.

Mbledhjen e kryesoi, Kemal Murseli- Kryesues i Kuvendit
Procesmbajtës, Makfire Malsiu.

Kryesuesi i Kuvendit z. Kemal Murseli: Të nderuar pjesëmarrës, së pari iu përshëndes të gjithëve, iu dëshiroj mirëseardhje, konstatoj kuorumin, prezentë për momentin janë 24 anëtarë, kushte pune për mbajtjen e mbledhjes kemi, e hapi mbledhjen e IX (nëntë) të rregullt të Kuvendit të Komunës për vitin 2022, data 29 shtator, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e kuvendit të komunës;
2. Propozim Vendimi për Buxhetin e Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2023 dhe vlerësimet për vitet 2024- 2025;
3. Draft Rregullore për ndryshim plotësimin e Rregullores 01Nr. 02-60/01-4863/20 datë 06.07.2020 për Taksat Komunale;
4. Propozim Vendimi për Transferin e mjeteve buxhetore;
5. Propozim Vendimi për lejimin e mjeteve për subvencionim të fermerëve;
6. Propozim Vendimi për themelimin e Muzeut të qytetit të Kaçanikut.

Lidhur me Rendin e propozuar të punës e hapi diskutim: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendin e punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës,

APROVON

Rendin e punës në përbërje prej 6 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikëve sipas renditjes:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës;

Vërejtje nuk pati në procesverbal, atëherë Kryesuesi i KK e shtroj në votim për aprovim Procesverbalin e mbledhjes së kaluar të KK dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës,

APROVON

Procesverbalin e mbledhjes së Kuvendit të Komunës (mbledhjes së 8 të rregullt), të datës 02.09.2022/ Lënda: 01Nr. 060/01-25025/22.

Kryesuesi i Kuvendit: Kalojmë në pozicionin e pyetjeve dhe kërkesave;

Pyetje dhe Kërkesa

znj. Kadrije Lika-Troni: Paraqiti një kërkesë të bizneseve të cilët operojnë në rrugën “Sali Bajra”, kërkesë kjo e adresuar edhe në drejtorinë përkatëse dhe në stacionin policor. Kërkesa është për çështjen e rrënimit të objektit të Çerdhes së fëmijëve dhe objektit të QPS, ku nga punimet e rrënimit të tyre, është pamundësuar kyçja nga rruga “Sali Bajra” në rrugën “Ismail Raka”, duke vendosur shtylla të metalta, makineri të rëndë, me çka e ka pamundësuar kalimin e automjeteve dhe udhëtarëve. Bizneset nuk janë kundër punimeve, por prishja e këtyre objekteve merr kohë dhe hapësira mes këtyre dy objekteve është e gjerë. Kërkojmë që pasi të përfundojnë punimet, mbeturinat e materialet e ngurta të largohen, të bëhet një trake për qasje në rrugën “Ismail Raka”, pasi bizneset janë të dëmtuara, se nuk dihet sa do të zgjasin punimet aty. Bizneset kërkojnë që para se të filloj ndërtimi i objekteve që do të ndërtohen, njëherë të hapet rruga alternative, pastaj të mbyllet apo ngushtohet rruga tjetër.

z. Adnan Reka: Iu përgëzoj që nuk keni grevë këtu në KK.

Kërkesë qytetare

1. Meqë buxheti komunal për vitin 2023 ka shënuar një rritje të konsiderueshme prej 1.308,373€ nga Grantet Qeveritare, dhe 173,148€ nga të HVK. Kërkojmë nga ekzekutivi komunal, të shpërndajë një pako të masave për përballje me inflacionin në nivel komunal, një masë prej së paku 150,000 € për familjet në nevojë, përmes shpërndarjes së druve për ngrohje apo pagesës së faturave të energjisë elektrike, me qëllim që familjet në nevojë të mund ta përballojnë më lehtë stinën e dimrit.

2. Çfarë doni të bëni me familjet që jetojnë pas xhamisë së dëshmorëve? Pas përfundimit të punëve të hekurudhës ato familje do të ngujohen plotësisht në shtëpi, sepse ata nuk do të kenë dalje tjetër përveç urës që ju e keni planifikuar mbi ‘nerodime dhe hekurudhë’ me një kod të ri prej 5,000 €, e në fakt nuk e di a e keni në plan ta realizoni dhe kur, sepse kjo duhet të jetë urgjente?

z. Rustem Zenuni: Kam një kërkesë për komisionin e zgjedhur për zgjedhjen e këshillave të fshatit. Unë po flas si anëtar i KK në emër të fshatit tim, se nuk pajtohem me atë rregullore e cila është bërë dhe kam qenë kundër. Kërkoj që komisioni të ndërpres njëherë zgjedhja e këshillave të fshatrave, sepse jemi të pakënaqur dhe nuk pajtohem me ndarjen dhe bashkimin

e fshatrave që janë bërë me zgjedhjen e këshillave të fshatrave, në të kundërtën ne e bojkotojmë këtë proces dhe nuk lejojmë me ardhur në fshatin tonë me i zgjedhur këshillat e fshatrave.

z. Naim Beça: Unë i kam disa kërkesa, si;

1. Pllakat të furra “ Oreksi” janë shkatërruar në total. Të Banka Ekonomike, shatki që është aty të rruga, pothuajse është shkatërruar.

Kërkoj të merren masa për rregullimin e këtyre prishjeve, sepse nuk janë shumë të kushtueshme.

2. Ura e hekurt që e lidhë bulevardin “Ismail Raka” me përroin e Rakocit, ka nevojë me u rregulluar, sepse po krijohet zhurmë e madhe gjatë vibrimit, sidomos gjatë natës.

3. Kanalizimi të stacioni i trenit është total i bllokuar, gjatë të reshurave atmosferike kanalizimi del jashtë, uji po hynë nëpër bodrume të shtëpive që janë aty dhe po krijohen aromë e keqe. Kërkoj që këto defekte me i sanuar, besoj se nuk kushtojnë shumë.

z. Agim Çaka: Janë do tema të vjetra të cilat i kemi ngritur edhe me herët, si: Rruga kah Guri i Shpum ‘Idriz Seferi’, rruga është e dominuar nga hedhja e mbeturinave. A i ka pa kush nga zyrtarët komunal mbeturinat në atë pjesë, unë nuk e di. Në këtë rrugë nuk është investuar, rruga është degraduar deri në atë masë, dhe nuk e di qytetarët që jetojnë në atë pjesë a kanë reaguuar ndonjëherë.

2. Projekti të sheshi i qytetit, është në zonë I të PZHU. Pyetja ime është: A kemi ndërhyrje në PZHK dhe a është në harmoni me ligjin për planifikim hapësinor ? Për derisa nuk e kemi ligjin e ri, ne e dimë se vlejnë ligjet e vjetra. A është bërë plani i ri dhe ky projekt, a është brenda planit të ri ?

Lidhur me pyetjet të cilat i kemi ngritur, unë e kam kërkuar çështjen e zërimit, a është e vërtetë se një herë është paguar për zërim shuma 19 mijë euro, herë tjetër 20 mijë euro. Me këto mjete komuna ka pasur mundësi për 2 vite me i blerë pajisjet e zërimit të veta me sistem të moderuar, ato pajisje me i lënë në shtëpinë e kulturës dhe me i përdorur për shumë vite. Po e ngriti këtë çështje se me intereson me tepër, çështja e shpenzimit të parasë publike, sesa kush po përfiton.

Kryesuesi i Kuvendit: Pyetje dhe Kërkesa tjera nuk kemi, besoj përgjigjet do t’i merrni me shkrim nga ekzekutivi i komunës. Kalojmë në pikën e radhës:

2. Propozim Vendimi për Buxhetin e Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2023 dhe vlerësimet për vitet 2024- 2025;

Ne si KK përmes KPF kemi organizuar Debat publik (DP) me qytetarë për buxhetin e komunës, pjesëmarrja ka qenë jo e kënaqshme. Ajo që na ka takuar si obligim ligjor e kemi kryer, debate publike janë organizuar edhe nga ekzekutivi i komunës me pjesëmarrje jo të kënaqshme. Mbetet me diskutuar forma e gjetjes se formave për pjesëmarrje të publikut në DP. Fjalën e ka drejtori i DBF, Bahri Selimi.

z. Bahri Selimi: Buxheti i komunës për vitin 2023 pas pranimit të Qarkores së parë buxhetore, janë caktuar kufijtë fillestar të buxhetit, me qytetarë dhe konsultime të brendshme me ekzekutivin për të gjitha kërkesat buxhetore që na janë adresuar, pastaj janë bërë organizime të dëgjimeve publike të cilat janë mbajtur, me pjesëmarrje jo të kënaqshme. Buxheti për 2023 është mbi 10 milion euro, kemi ngritje për 16% në krahasim me vitin e kaluar të GQ dhe të HVK. Rritjen e buxhetit e kemi orientuar të investimet kapitale, kryesisht të sektori i arsimit, të kultura, zhvillimi ekonomik, administrata komunale-për ndërtimin e parkingut nëntokësor. Shërbime publike -për ndriçim publik, kanalizim, rrugë. Subvencionet shënojnë rritje, në bujqësi, zhvillim ekonomik, të shërbimet publike -për rastet mortore, dhe të rastet sociale.

Kryesuesi i Kuvendit: Hapi diskutimin:

znj. Ardita Rrahmani: Kryetar, ju gjatë fushatës elektorale iu keni drejtuar qytetarëve të komunës me 94 premtime, edhe pse në të kaluarën nuk jeni njohur si person që premtoni, kësaj here e keni bërë dallimin me një numër të madh të konsiderueshëm të tyre. Po besoj se këto premtime të dhëna nga një kryetar tashmë për 3 mandate të plotë, supozohet që do të kishin qenë të mirë llogaritura, edhe pse në kalkulimet e tona nuk po duken se janë të tilla. Pasur parasysh edhe buxhetin aktual të rritur të komunës që është për tu përshëndetur, premtimet e juaja duken të jenë vështirë të realizueshme. Po e filloj me premtimin e ndërtimit të shkollës fillore “Emin Duraku” në Kaçanik, e që në propozim buxhetin e komunës së këtij viti është një kod thjeshtë i bartur e nuk ka asgjë prej kësaj pune, as këtë vit, duke vazhduar njëjtë edhe me aneksin e shkollës së mesme “Skënderbeu” që po ashtu nuk është përfshirë në buxhet. Premtimi tjetër i mirë në të dëgjuar e i domosdoshëm në praktikë, por jo prioritet nga ju është edhe instalimi i kamerave të sigurisë në të gjitha objektet shkollore. Për të vazhduar në ekonomi, ku keni thënë se do t’i ndihmoni bizneset e dëmtuara nga pandemia, gjë për të cilën nuk kemi njohuri se keni bërë gjë të tillë. Me dorë lirë në premtime jeni treguar në infrastrukturë e urbanizëm ku keni dhënë goxha premtime, si: Ndërtimin e trotuarit, Ndriçimin publik dhe stazës për çiklizëm në rrugën “Dëshmorët e Kombit” në Dushkajë, Ndërtimin e segmentit të rrugës, Shtëpi e Kulturës-Xhami e Dëshmorëve, Ndërtimin e shtratit të lumit Neredime, segmenti, Xhami e dëshmorëve- Runjevë, Përfundimin e rrugës që bënë lidhjen mes Kaçanikut –Runjeves dhe Stagoves dhe Gërllicës. Ndërtimi i trotuarit, ndriçimit publik dhe stazës për çiklistë në rrugën “Qamëria” Bajnicë-Rakaj. Nuk besoj të keni harruar se ju ke premtuar edhe këtë qytetarëve të asaj zone. Madje, Ndërtimin e një fabrike për trajtimin e ujit të pijes në Sepetin-Dubravë, kur për këtë keni bërë kod të ri buxhetor, nuk e ke parë si prioritet as në vitin e dytë të mandatit të tretë qeverisës. Po ashtu keni premtuar edhe Ndërtimin e një rrethi tek ura e konakut, e duke njohur e frekuentuar atë pjesë aq shumë, nuk e di se për ku e keni paraparë, gjithsesi është premtua. Për mos me lënë në harresë tashmë lirisht mund të themi premtimin historik, Ndërtimin e parkingut të komunës për administratën dhe aneksin e komunës. Keni premtua edhe Hartimin e një strategjie të re turistike, që deri me tani janë vetëm premtime e që për zhvillimin ekonomik e kulturor të komunës, janë ABC-ja e zhvillimit. Të rinjtë në rrethinën e Kaçanikut, aktivitetet sportive momentalisht i luajnë në ndonjë pronë private, apo fushë të improvizuar e është rregullimi i terreneve sportive në rrethinë e keni pasur premtim por me gjasë veç si i tillë po mbetet. Të nderuar kolegë e sidomos ju asamblastë, e sidomos ju që vini nga radhët e pushtetit, e di që sot do të votoni këtë buxhet të hartuar, por vënia edhe ju një sy premtimeve të bëra gjatë fushatës dhe i gjeni jo vetëm këto që i përmenda, por edhe dyfishin e këtyre që nuk gjenden në buxhetin e vitit 2023. LDK me forcën e vet sado të vogël në KK, do të jetë këtu, t’iu tregoj sy me sy se fjalët gjatë fushatës suaj, nuk përkojnë me realizimin në vepra gjatë qeverisjes tuaj.

z. Agim Mani: Jemi në kohën kur duhet mendojmë dhe planifikojmë orientimin e projekteve, me ia dhënë kohen komunën tonë, që t’iu shërbejmë qytetarëve sipas qarkores buxhetore të kategorisë së shpenzimeve. E falënderoj qeverinë - ministrin e MEFPT për buxhetin e ndarë komunave të Kosovës. Buxheti i ndarë në vitin 2023 është 15% më i lartë buxheti i komunave sesa në vitin 2022, rritje me e madhe që ka ndodhë ndonjëherë falë rritjes buxhetore të hyrave të shtetit, 554 milion euro që iu ndahen komunave, të cilat mjete komunat do t’iu kryejnë me shumë shërbime qytetarëve. Nga kjo ngritje buxhetore ka përfituar edhe komuna jonë grantin qeveritar me ngritje si asnjëherë me parë. GQ është 9,812,111.00€, të HVK 862,578.00€, ku buxheti i përgjithshëm i komunës për vitin 2023 është 10,674,689.00€. shikuar në total në raport me vitin 2022 shënon rritje për 16. 12%, kjo është për t’u përshëndetur. Ekzekutivi i komunës duhet t’i orientoj këto mjete në projekte kapitale në shërbim të qytetarëve në bazë të nevojave të qytetarëve kur dihet se investimet kapitale janë parakusht për zhvillimin e vendit dhe përmirësimin e kualitetit të jetës së qytetarëve. Gjatë dëgjimit publik nuk po arrihen me marrë pjesë qytetarët me i dëgjuar shqetësimet e tyre, drejtori tha kjo është përgjegjësi e qytetarëve, ndërkaq unë mendoj kjo është përgjegjësi e ekzekutivit që nuk ka arritur me i sjellë qytetarë në DP, si pasojë e praktikave të mëhershme që nuk përkon me gjendje në terren dhe

neglizhenca për projekte. Në këtë ndarje buxhetore ka diskriminim dhe keq planifikim të projekteve dhe prioriteteve. Janë futur shumë kode buxhetore pa pasur mundësi që këto projekte me kode buxhetore me u realizuar. Disa kode janë të përsëritshme dhe disa janë kode të reja, kryesisht në këto kode janë bllokuar të hyrat vetanake, nga 59 projekte, 26 janë futur si kode të bllokuara me vlerë mbi 130,000 € nga të HVK. Në anën tjetër, nga mjetet e bashkëfinancimit të projekteve janë ndarë vetëm 100.000€, d.m.th. me shumë ka kode buxhetore sesa financim të projekteve, kur dihet se ministria nuk investon, nuk bashkëpunon në këto projekte me kode buxhetore, por ministria bashkëpunon –investon me projekte që janë me bashkëfinancim. Të kodet buxhetore kërkohet vetëm projekti, ndërkaq të tjerat me donacione të ndryshme. Të zhvillimi ekonomik, keni paraparë ndërtimin e shkallëve të Guri i Shpuar, kjo është keq orientim i projektit, sepse për me pasur zhvillim ekonomik, fillimisht duhet të krijohet infrastruktura, keni ndarë mjete për shkallet, ndërkaq nuk keni ndarë për rrugën “Idriz Seferi”, shtrohet pyetja kah do të shkohet në këto shkallë. Disa fshatra janë lënë anash në prioritete, si f. Gllloboçicë, fshati me i largët, duhet me iu krijuar kushte dhe mundësi qytetarëve mos me lëshuar fshatin, siç ka ndodhur me fshatrat tjera. F. Stagovë, prej nga vijë unë, në vitin me këtë planifikim buxhetor nuk është paraparë të shtohen rrugët e mbetura. Të pagat dhe mëditjet rriten shpenzimet në këtë kategori mbi 300 mijë euro në vitin 2023, a rritet numri i të punësuarve me këtë ngritje, dhe sa keni planifikuar me rritur këtë numër të punësimit.

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi: Ne jemi këtu sot me votuar buxhetin për vitin 2023 dhe projeksionet për vitet 2024-2025. Obligimi i opozitës është me na kritikuar, por me bërë politikë kaq shumë, nuk po e shoh të arsyeshme. Të diskutimi i Arditës, është e vërtetë që për herë të parë kanë dalë disa premtime shumë të mëdha nga granti i 4, të cilat mjete nuk na janë dhënë. Krejt ato projekte të mëdha të cilat janë premtuar me grantin e 4 i kam bërë me një fusnotë se nuk kam mundësi me i realizuar, janë shtyrë për vitin vijues. Projektet tjera, besoj se 90% do të realizohen, janë paraparë për mandat 4 vjeçar. Projektet me fusnotë i kam llogaritur diku 12 milion, me vlera reale qysh ka qenë çmimi i tregut. Të kodet buxhetore të projektet me bashkëfinancim, kodet i kemi, kërkesat janë bërë, por nuk është realizuar asnjë, tani nuk kemi lënë shumë se mund të na ikë përsëri bashkëfinancimi. Me bashkëfinancim ka pasur mundësi me u realizuar edhe rruga “Idriz Seferi” ose ndonjë donacioni tjetër, siç ishte rasti me donacionin islamik për sera. Të kodet, me 5,000€ nuk realizohet asnjë projekt, por pa qenë i koduar projekti, si të shkolla “Emin Duraku” është koduar si projekt, nëse ministria na jep donacione, atëherë ne e kemi formën e bashkëfinancimit për realizim të projektit, përndryshe pa kode nuk e dimë se ne cilat projekte mund të kemi donacione, shpresojmë të ndahet viti vijues granti i 4, nëse neve na takojmë 3 milion, atëherë e kemi projektin e shkollës “Emin Duraku” dhe fillojmë me procedura të prokurimit. Të shkallet, ne i kemi paraparë se kemi menduar se ministria sivjet e realizon projektin e rrugës 176.000 € që i ka paraparë, dhe nuk e realizoj por na i hoqi mjetet, na i la vetëm 50,000 €. Në f. Gllloboçicë, më së shumti është investuar, tani jemi duke përfunduar projektin e ujësjellësit dhe unë nuk di çka i mungon tjetër këtij fshati.

z. Agim Mani: F. Gllloboçicë ka probleme me çështjen e kanalizimit. Këtë e ka përmendur delegati i partisë tonë nga ajo anë, pastaj është çështja e rrugicave, se që 20 vjet nuk është bërë asgjë.

Kryetari i Komunës: Të rrugët-rrugicat nuk kemi lënë emra, ju nëse keni ndonjë projekt madhor, është mirë me e potencuar. Është investuar edhe në Stagovë, sivjet do të realizohet projekti i rrugës: Teneq-Stagovë me vlerë të projektit 300,000€, rrugicat do të bëhen me bashkëfinancim të projekteve, është investuar në Stagovë në rrugë dhe kanalizim.

znj. Ardita Rrahmani: Desha të lidhem me diskutimin e kryetarit, premtimet e juaja duhet me u zbatuar e jo vetëm të mbesin në letër. Opozita e ka për obligim me iu mbajt për fjale se fuqia e opozitës është kjo. Në anën tjetër, nga 94 premtime, u përmenden premtimet me fusnota, i kam pa projektet që financohen nga grantet qeveritare, por nuk i kam përmend ato. Nga

buxheti i projektuar me rritje, 52% e mjeteve shkojnë në paga, mjetet tjera shkojnë për subvencione dhe transfere, mallra e shërbime, shërbime komunale, diku 28% do të shkojnë për investime kapitale. Nisur nga kjo shumë dhe shumën që e kemi kalkuluar ne si LDK, mendojmë se premtimet të cilat i keni dhënë, me këtë buxhet nuk mundën me u realizuar.

z. Bahri Selimi: Premtimet e kryetarit kanë filluar me u realizuar qysh në vitin 2022. Shkolla fillore “Emin Duraku” është në projekt, Instalimi i kamerave të sigurisë në objektet shkollore, sivjet është punuar në këtë drejtim, përkrahja e bizneseve me taksë 0, ka vazhduar, shfrytëzimi i pronës komunale që shfrytëzojnë, bizneset janë liruar nga disa taksa. Tatimi në pronë, për pronat komerciale i kemi ulur tatimet, pjesa tjetër e lirimit të bizneseve dhe subvencionimit i takojnë qeverisë. Infrastrukturë rrugore u pajtuat edhe ju që është punuar dhe janë ndarë mjete, Parkingu komunal, janë 150.000€ për parking nëntokësor. Hartat turistike, drejtorja sivjet ka filluar me realizimin e tyre + një strategji tjetër. Të diskutimi i Agimit; Buxheti është ngritur, 15% në grante, 1% të HVK, të HVK rriten krahas performancës që tregon komuna dhe ministria i ngrit projeksionet, nëse e shoh se komuna nuk mund të mbledhë të HVK atëherë e ulë projeksionin. Ne e kemi pasur performancën e mirë dhe na i kanë ngritur shumën edhe për 173 mijë euro. 52% janë të pagat, nga ngritja buxhetore gjysmë milioni i kemi ndarë për investime kapitale, 28% të shumën së përgjithshme të buxhetit. Të pagat, 801-804, në vitin e ardhëm është 819 punëtorë, d.m.th. shtohen një 15 pozita të sektori i arsimit dhe shëndetësisë, 117 sektori i shëndetësisë, duke u shtuar edhe vizitat në familje dhe puna pas orarit, 3 pozita në arsim, në sektorin e administratës nuk është shtuar ndonjë pozitë. Në vazhdim drejtori sqaroi mjetet se ku shkojnë që janë ngritur të pagat. Të kodet, ne duhet me pasur kodet për memorandumet e arritura të bashkëpunimit dhe janë shtuar kodet. Në këtë vit që jemi kemi pasur memorandum të bashkëpunimit rregullimi dhe asfaltimi i rrugës Kaçanik i Vjetër-Gërllicë, Segmenti –Runjevë-Stagovë, me kod 5.000 €. 291.57 €, nëse është kodi, shtohen mjetet. MAPL 236.000€ me bashkëfinancim të projektit. Projektet, si shkolla “Emin Duraku” nuk realizohet me këto mjete, si në kod, se realizimi i këtij projekti kushton diku mbi 3 milion.

z. Naim Beça: A keni projekt për ndërtimin e shkollës fillore “Emin Duraku”, se u përmend se për parking ka projekt, ndërkaq çështjen e kamerave në shkolla, kjo është në përgjegjësi të ministrisë.

z. Bahri Selimi: Për projektin e shkollës, iu sqaroi me mirë drejtori i DUKMM Qamil Stagova.

Kryetari i Komunës: Të çështja e projektit të shkollës “Emin Duraku” kemi lënë kod, me atë fusnotën. Kriteret janë për kokë nxënësi dhe m2, varësisht nga numri i nxënësve bëhet projekti. Ministria i ka projektet e gatshme, në momentin që bëhet ministria e kërkon projektin me futur në buxhet, edhe kjo bëhet, vetëm të na jepet drita jeshile. Të kamerat, kamerat e qytetit i monitoron ministria e punëve të brendshme, sikurse ne që e kemi bërë një projekt, para 5-6 viteve, se nuk e kemi ditur dhe na u dërgua një rregullore se na nuk kemi të drejtë se monitorohen nga ministria, ndërkaq të shkollat është e drejtë e jona monitorimi i kamerave.

znj. Ardita Rrahmani: Po e përmendim shkollën “Emin Duraku” se është shkolla me e madhe në komunë, objekti i shkollës nuk ka sallë të edukatës fizike për shkak të hapësirës se hapësira është shndërruar në klasë e që ka 5-6 vite nxënësit e asaj shkolle në sezonin e dimrit nuk po mundën me zhvilluar aktivitete fizike në atë shkollë. Mirë është që janë ndarë mjetet për salla të kulturës fizike në rrethinë, se është shumë e nevojshme, po a nuk vlen e njëjta edhe për këtë shkollë, deri sa të ndërtohet shkolla e re me iu bërë zgjidhje.

Kryetari i Komunës: Shkolla “Emin Duraku” i ka 1500 nxënës dhe e ka një shkollë dhe një sallë- shkolla të Kisi, 500 nxënës të asaj shkolle e kanë sallën. Komuna e Kaçanikut i ka pasur deri vjet 7000 nxënës dhe ata asnjë sallë nuk e ka pasur, edhe ata janë nxënësit tonë, dhe jemi duke pretenduar me bërë një shkollë të re “Emin Duraku” me gjithë një sallë. Tualetet në këtë shkollë kanë qenë me emergjente dhe është investuar 70 mijë euro dhe me është dhimbur ai

investim për aneksin e tualeteve. Nëse nuk bëhet shkolla, ne jemi duke menduar me bërë sallën, është e katërta herë që e bëjmë kodin për këtë shkollë, shpresojmë të bëhet shkolla me gjithë sallën., është bërë salla në shkollën e Begracës, shpresojmë se çdo shkollë ministria e bënë me sallë.

z. Rustem Zenuni: Desha të lidhem me diskutimin e Agimit për çështjen e debateve publike me qytetarë, ai është anëtarë i KPF, kuvendi ka organizuar debat, nuk mundesh me akuzuar për mospjesëmarrje të qytetarëve në DP që i organizon ju-KPF. Unë kam marrë pjesë në atë debat pa qenë anëtarë i KPF, edhe unë e kam luhatur besimin ndaj teje, e lere më qytetarët. U cek se janë rritur të hyrat nga qeveria, pse nuk po e cekni që nuk është investuar këtu asgjë nga ministria. Nëse janë rritur të hyrat nga ministria, ata e kanë obligim, vendimet e mira i përshëndes sa herë. U bërë shumë zhurmë për rrugën “Idriz Seferi” asgjë nuk ka bërë ministria, u hoqën mjetet për këtë projekt, qytetarëve duhet me ua dhënë përgjigjen. U tha se nuk është bërë asgjë që 20 vjet, se para 20 vjetëve për sa kohë kishe ardhur nga Stagova e për sa vjen sot. Ju vini këtu dhe nuk e vlerësoni atë që e kanë vlerësuar qytetarët. Qytetarët janë ata që kanë vendosur me udhëhequr komunën kjo parti-PDK, se kemi pasur program dhe kemi marrë besimin e tyre.

z. Naim Beça: Pse po na drejtohesh neve z. Zenuni, se ne nuk të japim ty përgjigje?

z. Agim Mani: Unë e tregova një realitet. Qeveria e ka ngritur GQ në bazë të performancës, kjo është një realitet. Debatet publike organizohen për qytetarë e jo për anëtarë të KK, për me i shprehur shqetësimet. Pjesëmarrja jo e kënaqshme e qytetarëve, faji është i juaji.

z. Adnan Reka: Vendi për me diskutuar është i anëtarëve të KK. Ekzekutivi kanë të drejtë me u përgjigjur në pyetjet tona, ndërkaq nëse e matim kohën, me shumë shihet se po diskuton ekzekutivi sesa anëtarët e KK.

Kryesuesi i Kuvendit: Unë po mundohem me krijuar një balancë të diskutimeve, por nuk po jeni në gjendje me dëgjuar deri në fund atë që flet dhe po ndërhyini në diskutime. Të dëgjojmë njëri tjetrin, mos të zhvillojnë debat interaktiv sepse nuk kuptohemi ashtu.

z. Adnan Reka: Së pari më lejoni të pyes për Impiantin për trajtimin e ujërave të zeza, çfarë ka ndodh me projektin e vjetër që ishin shpronësuar 7 hektarë tokë në Kaçanik të Vjetër, e që kodi buxhetor prej 5,000 €i atij projekti bartej prej viti në vit, ndërsa tani shoh se kemi një projekt të ri për Impiant dhe një kod të ri buxhetor, sërish 5,000 €? Nuk mund ta quaj planifikim të mirë, Një buxhet që njëherë shpenzon para për rrënimin e një Çerdhe optimale për fëmijë, e më pas të shpenzojë për ndërtimin e një çerdhe të re për shkak të keq-planifikimit. Nuk mund ta quaj planifikim të mirë. Një buxhet që njëherë shpenzon para për rrënimin e Qendrës për Punë Sociale, e me pas te shpenzoje për ndërtimin e saj. Nuk mund ta quaj planifikim të mirë, Një buxhet komunal që për zhvillim ekonomik parasheh vetëm 3 projekte në vlerë prej 165,000 €, e në anën tjetër ka 25 kode buxhetore me nga 5,000€, për tu bartur vit pas viti në buxhetet në vijim. Në vend se të buxhetin një sallë për Kuvendin Komunal, ju shpenzoni 135,000 € për Ndërtimin e parkingut nëntokësorë për administratën komunale. Në vend se të buxhetin një mekanizëm për filtrimin deri në një masë të caktuar të ujit të lumit Nerodime, ju kot shpenzoni mbi 100,000 € për rehabilitimin e shëtitores përgjatë lumit Nerodime. Në vend se të ndërtoni një sallë sporti më tepër për shkollën e Kovaçecit, ju më kot shpenzoni 135, 000 €, për zgjerimin e hyrjes së shkollës dhe një ashensor në Gjimnazin “Skënderbeu”. Ju keni vendosur të subvenciononi transportin e nxënësve vetëm për shkollën profesionale “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka”, ndërsa ne ju themi transporti i nxënësve duhet të jetë falas për të gjithë nxënësit e komunës, privilegjimi i nxënësve përmes transportit falas në atë shkollë nuk nënkupton ngritje të cilësisë, ky veprim nënkupton diskriminim për të gjithë nxënësit e tjerë që kanë nevojë për transport. Kodet buxhetor me nga 5,000€, sa për sy e faqe, për shkollën fillore

‘Emin Duraku’ dhe rrugën ‘Idriz Seferi’ në zonë urbane, vërtet janë diskriminuese. Shkolla “Emin Duraku”, të cilën asnjëri nga ne nuk e mban mend ndërtimin saj, ka më tepër se 500 nxënës dhe është shkolla më e madhe dhe më e vjetër në komunë, ndërsa rrugën “Idriz Seferi” që është në zonën e parë tatimore, që 7 vite ka mbetur në një gjendje të shumë të keqe vetëm për 167,000€, sipas jush. Pra, unë konsideroj se prioritet dhe cilësia e projekteve për ju nuk kanë rëndësi. Për mua, edhe ky draft-buxhet komunal është i ngjashëm me buxhetet e viteve paraprake, pavarësisht se ky draft-buxhet është rritur për 16%, apo gati për 1,5 milion euro, nga kjo Qeveri si asnjëherë më parë, dhe një shumë më e vogël nga të HVK, ky draft-buxhet prapëseprapë nuk premton ndonjë zhvillim ekonomik për komunën, sepse nuk është i orientuar kah qytetarët por nga operatorët ekonomik.

z. Betim Shala: Sa i përket propozim Buxhetit, unë nuk pajtohem me shumë pika, për faktin se në rrugën “Idriz Seferi” janë paraparë vetëm 5,000€, kur dihet se rruga i ka 1200m me 6 metra gjerësi, e kishim shtruar atë rrugë me diku 140.000€ zhavorrin dhe një shtresë asfalt 7cm, ndërtimin e trotuarit se është dëmtuar pak dhe ndriçimin. Me mirë me 70,000 € për shkallët, ka qenë me mirë me ndërtuar rrugën- fazën e parë të projektit, pastaj me mbërrit të shkallët e parapara. Të bulevardi “Ismail Raka” hapja e rrugës deri Xhamia, janë 1380m² me u shpronësua sa e di unë. Ministria e ka vlerësuar 10,000€ shpronësimin, edhe nëse ministria vendosë me investuar në atë rrugë, ne nuk i kemi mjetet për shpronësim me realizuar projektin. Sa i përket projektit të shkollës fillore “Emin Duraku”, projekti kryesor është i punuar, ne duhet me marrë projektin me kërkuar nga ministria me na e financuar.

Kryetari i Komunës: Unë iu përgjigja edhe Arditës, Për deri sa nuk kemi sinjal nga ministria, se do të futet në kodin buxhetor në vitin vijues ndonjë projekt, është e paarsyeshme me i lënë projektet në sirtarë të ministrive. Unë e përmenda se ministria i ka projektet e veta për shkolla, për shkak se e ka një tender, për kokë nxënësi me m², sikurse janë ndërtuar shkollat në Doganaj dhe shkolla në Kaçanik të Vjetër. Në momentin që ministria thotë se nuk kam projekt të gatshëm, ne e kemi të kontraktuar kompaninë projektuese, dhe besoj se e bëjnë projektin, por e di se nuk e bëjmë me cilësi siç i ka ministria, jam i bindur se çështjen e projektit nuk e kemi problem, vetëm se a do të kemi fat me u futur në kodin buxhetor në vitin vijues.

z. Agim Çaka: Tema e buxhetit është temë shumë e rëndësishme që nxit debat, duhet të fokusohemi në çështje që janë në interes të përgjithshëm. Buxheti i propozuar është një buxhet që kishte me na ndihmuar mjaftueshëm në zhvillimin ekonomik dhe mirëqenie të qytetarëve tonë, nëse orientohet mirë dhe shpenzohet mirë. Çështjet që ngritën nga anëtarët e KK, duhet të sqarohen, se ne nuk jemi të fushës dhe nuk i kuptojmë sa duhet. Nëse e shikojmë buxhetin, diku 52% shkojnë për paga dhe mëditje. Duke e pa këtë shifër, unë si anëtar i KK e kam për obligim me votuar buxhetin, që njerëzve me u hapur rrugën me i marr pagat. Pjesa tjetër që duhet me orientuar për investime kapitale, duhet me bërë në formë sa me të drejtë orientimin e tyre, se projekte kapitale ndikojnë në zhvillimin ekonomik të komunës. Mjetet që i marrim nga buxheti, pagat është mirë të shpenzohen në komunën tonë, se kjo ndikon në zhvillimin e komunës tonë. Ka disa projekte të cilat nuk i kam pa në këtë planifikim, Kycja në autostradë, projekt ky që kishte me ndikuar me bërë atraksion brenda komunës që me tërheqë vizitorë, qoftë me muze apo kalanë e qytetit, se kjo ndikon që mjetet të mbesin në komunën tonë. Ka shumë probleme tjera që e bëjnë të vështirë jetën e qytetarëve tonë, si çështja e kanalizimeve, mbeturinat vend e pa vend, kështu që duhet investuar në zhvillim ekonomik dhe krijimin e mirëqenies së qytetarëve

znj. Kadrije Lika-Troni: Kur jemi të plani i ndarjeve buxhetore të vitit 2023, të çështja gjinore, unë me herët pata kërkuar me futur një kod të zyra për barazi gjinore dhe të punësohet edhe një femër. Unë e shoh se është vetëm një punëtor në atë zyrë. A është një punëtor, sepse nëse është vetëm 1 punëtor, atëherë duhet të bëhet barazia gjinore në atë zyrë?

z. Adnan Reka: A ka mundësi me na treguar sa e ka pagën zyrtari për barazi gjinore, sepse me llogaritjet tona po na del 618 € në muaj ?

Kryetari i Komunës: U tha se është ngritur numri i punëtorëve në arsim dhe shëndetësi, nuk i kemi rritur ne, kjo është politikë e ministrisë, ne nuk jemi kundër, e kemi mbështetur këtë rritje. Të ZBGJ, është një person përgjegjës, edhe unë nuk jam pajtuar me këtë fakt vetëm një punëtor në zyre dhe me qenë përgjegjës, por është një rregullore e nivelit qendror që e përcakton. Unë pajtohem me mendimin e Adnanit, por nuk mundem me ndryshuar rregulloren.

z. Naim Beça: Të çështja e debateve publike, e kam përmendur edhe me herët, nëse qytetarët nuk marrin pjesë në dëgjime publike për buxhet, apo ndonjë çështje tjetër, nuk është përgjegjësia e qytetarit. Ne duhet me menduar pse nuk vijnë në dëgjime publike, përgjegjësia është e komunës. Mospjesëmarrja e qytetarëve në dëgjime publike të bënë me kuptuar se diçka nuk është në rregull. Secili nga ju, vetëm nga një shok me sjellë në DP, ishin bërë 20 veta. Po lidhem me diskutimin e delegatit që tha se PDK ka pasur projekte dhe e ka votuar populli. Partitë politike nuk janë ndërmarrje publike për ndërtime. Kur vjen ne pyetje çështja politike, ne kemi qëndrime të ndryshme, aty dallojmë. Ne i dimë rrethanat se qysh janë votuar, andaj kujdes kur na drejtoheni si parti politike.

Kryesuesi i Kuvendit: Pajtohem Naim me juve se partitë politike kanë qëllime të ndryshme. Ne, pse jemi në parti të ndryshme politike, shpesh herë mundemi me u kuptuar për çështje të ndryshme edhe jashtë qëllimit politik, dhe duhet të ishte ashtu, por kjo ndodhë shumë rrallë.

z. Rustem Zenuni: Faleminderit anëtarit për sqarim, Unë e kam dhënë një betim në këtë KK, për mbrojtjen e interesave të qytetarëve. Kur është ndërtuar autostrada, kam dalë kam protestuar kundër qeverisë. E kam përkrahur ndërtimin e rrugës “ Ahmet Kaçiku” – Fusha e Pajtimit-Shtërpçë, ndërkaq nuk e kam problem me qenë kundër, pavarësisht kush është në qeveri.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime tjera nuk ka, atëherë Propozim Buxhetin e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me 15 votë Për, 10 votë Kundër. Pjesëmarrës në votim 25. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Buxhetit të Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2023 dhe vlerësimet për vitet 2024- 2025 / Lënda: 01Nr. 400/01-25102/22.

3. Draft Rregullore për ndryshim plotësimin e Rregullores 01Nr. 02-60/01-4863/20 datë 06.07.2020 për Taksat Komunale;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: ne mendojmë se para se të ngritën tarifat e përcaktuara në dispozitat e nenit 29 të rregullores për taksat komunale, fillimisht të aplikohen forma tjera, kur dihet se inflacioni e ka përfshirë edhe komunën tonë. Aty ku kemi mundësi, të ndikojmë ne të kompania publike që në këtë kohë mos të bëjmë ngritjen e taksave. Fillimisht duhet kërkohet nga kompania të bëjmë mbulueshmerishtë e territorit, se ka disa lokacione që nuk e kryen shërbimin kjo kompani, kurse në anën tjetër kërkohet ngritja e taksave, kur dihet se ky kuvend ia ka dhënë në menaxhim kësaj kompanie parkingun, që i sjell të hyra. Pyetje për drejtorin, fillimisht është dashur të kërkoj nga ekzekutivi një buxhet të ndihmoj kompaninë, pastaj t'i ngritëm tarifat. A është paraparë me iu ndarë buxhet kësaj kompanie? Në këtë kohë ne jemi me i përkrahur qytetarët e komunës dhe jemi kundër ngritjes së tarifave.

z. Adnan Reka: Në vend se komuna të inkurajojë kompaninë “Pastërtia” për rritjen e inkasimit dhe të cilësisë, dhe nëse është nevoja edhe ta subvencionojë kompaninë dhe t’ia lirojë barrën qytetarit, ju të vetmen alternativë e shihni t’i ngarkoni edhe më tepër ata qytetarë që paguajnë duke ua rritur çmimet për shërbimin e mbeturinave në këtë kohë të inflacionit global. Kjo është e padrejtë, andaj unë do të votoj kundër.

z. Betim Shala: Në emër të LDK , duke marrë parasysh planin e ri për mbulueshmeri 100 % dhe ngritja e çmimit nuk është e madhe në raport me tarifat aktuale, kështu që ne LDK e përkrahim këtë ngritje të tarifave.

z. Agim Çaka: Unë jam kundër çdo ngritje të tarifave në këtë situatë krize, pa marrë parasysh se kanë ndryshuar çmimet, pa marrë parasysh se çmimet nuk janë në harmoni me ngritjen e pagave dhe rritjen e mirëqene së bizneseve të qytetarëve.

z. Ramadush Osmani: Kjo çështje ka ardhur në KK si rrjedhojë e kompetencave të KK të ligjit për mbeturina dhe rregullorja komunale që ia përcakton qartë kompetencën komunës në raport me tarifat. KK e analizon tarifat për mbeturina, dhe monitorohet një propozim i ngritje e tillë, e jo sikur tregu i lirë që po ngritën çmimet pa ndonjë konsultim publik të cilat po ndikojnë tek qytetarët dhe ndërmarrja. Propozimi ka ardhur si kërkesë nga kompanisë “Pastërtia”, ka kaluar debatet publike me qytetarë, e cila arsyetohet me ngritje aktuale në nivel vendi. Ngritja e derivateve është aspekti kryesor që ndikon në kosto operative të kompanisë. Ne jemi aksionar të NP dhe jemi përgjegjës për mbarëvajtjen dhe operimin e kompanisë që mos të falimentoj. U tha se me rritjen e mbulueshmerisë do të ngritet të hyrat. Çdo mbulueshmerisë ka kosto, sepse kompania paguan për bartjen dhe deponimin e asaj mbeturine, edhe nëse hynë në sistem 100% e mbeturinave. Ferizaj e ka miratuar ngritjen e tarifave për 39% dhe ka kërkuar të bëhet një unifikim i tarifave. Ne kemi propozuar ngritje 30% për ekonomi familjare dhe kategorinë e parë të bizneseve, si trafika etj., ndërkaq kategoritë tjera të bizneseve me 25%, për shkak se niveli ekonomik i komunës tonë është dukshëm më i ulët sesa i komunës së Ferizajt. Në debat publik kemi marrë opinionet edhe me grupet e interesit dhe iu është ofruar KK si propozim. Se a do të subvencionohet kjo ndërmarrje, ne veç kemi ndihmuar në formë të granteve për mjedis të pastër dhe në makineri me 4automjete të reja nga granti i performancës, në zonat ku operohet është mundësuar të rritet efikasiteti me 100%. Njësisia i ka 40 punëtorë dhe këtyre iu ka rritur kostoja e jetesës, që e kanë burimin e vetëm nga inkasimi i tarifave. Analizat që janë bërë nga ekonomistët ka rezultuar se kostoja e operimit është nën mundësitë e operimit me tarifat aktuale. Duke marrë parasysh inflacionin, KK ka mundësi me i ngritur tarifat, por nëse në të ardhmen zbresin derivatet, kemi mundësi me i me i rishqyrtuar tarifat dhe me ia përshtatur nevojave të qytetarëve, sepse tarifat që i kemi mund të afektojnë edhe kompanitë private që operojnë në zona të caktuara. Parkingjet ne iu kemi ofruar kompanisë, në ofrimin e shërbimit për komunën i cili shërbim ka kosto, se 2 punëtorë janë me pagë dhe 4 që merren me dhënien e biletave për parking, se menaxhimi i parkingut dhe hapësirave publike kanë kosto.

z. Adnan Reka: Ju e potencuat drejtor se kompania publike “Pastërtia” ka punuar me humbje, edhe pse komuna në vazhdimësi e ka subvencionuar në formë të granteve siç e potencuat. Pyetja: A keni bërë ndonjë analizë që duhet të jetë profitabile, që 15 vjet punon me humbje? Nëse një kompani publike punon për 15 vite me humbje, dhe nuk gjinden arsyet, dhe duke e subvencionuar edhe para ngritjes se çmimeve globale, atëherë unë besoj se defekti është të ju e jo të kompania, se ju jeni përgjegjës se jeni aksionar i kompanisë dhe duhet gjetur arsyet dhe me marrë masa. Derisa për 20 vjet nuk keni arritur me kuptuar arsyen dhe me marrë masa, atëherë me vjen keq mua.

z. Ramadush Osmani: Unë nuk thashë se kompania ka punuar me humbje që 20 vjet. Tani pas ngritjes se inflacionit- ngritjes se çmimeve, është duke u parë se kostoja e operative e

kompanisë është rritur. Nëse në 100 km ka kushtuar 100€, tani me ngritjen e derivateve, kushton me tepër dhe kjo afekton në qëndrueshmëri financiare aktuale. Edhe nëse e rrisim mbulueshmerinë, %% dhe do të bëjmë, do të ketë kosto se shtohen mbeturinat. Jemi duke menduar për punëtorët të cilët punojnë aty, se i kanë pagat e vogla 250-300 € dhe iu ka ngritur kostoja e jetës dhe nuk mund të ecin në hap me pagën minimale, ose me ngrije në nivel të inflacionit, nëse nuk kanë burim të sigurt financiar, nëse nuk e kanë të vetmin burim inkasimin e tarifave dhe menaxhimin e parkingjeve. Të hyrat aktuale në planin e biznesit të kompanisë, nuk ia mundësojnë për investime kapitale, edhe për paga edhe mirëmbajtjen e automjeteve dhe të blejë automjete, kështu ne ia kemi mundësuar blerjen e makinerisë së re.

z. Adnan Reka: A ka operuar ndonjëherë me fitim kompania, na e sjell një raport se kur ka operuar?

z. Ramadush Osmani: Sigurisht se ka operuar me fitim, por jo në nivelin me blerë një automjet 190,000 €.

z. Naim Beça: Pasi e ka marrë në menaxhim parkingun kompania “Pastërtia” a iu ka përmirësuar gjendja punëtorëve të kompanisë ? Të gjithëve na dhimben punëtorët që punojnë aty, se është ndër punët me të vështira, jo vetëm këtu në Kaçanik, por në tërë botën. Paga që po thoni e marrin, është shumë e vogël, a iu ka përmirësuar gjendja, pasi që e kanë marrë në menaxhim parkingun, i kanë marrë edhe 4 punëtorë ? Na sqaroni me konkret, sa është ngritur çmimi në raport me tarifën aktuale, jo në përqindje. Gjendja ekonomike është rënduar tek të gjithë në gjithë botën, kështu mos të shikojmë vetëm kompaninë, por edhe popullatën tjetër se sa ndikon ngritja e çmimit në jetën e tyre.

z. Ramadush Osmani: Unë i kam potencuar në draft tarifën aktuale pa TVSH, nga 4.31 të ekonomia familjare rritet në 5.60€ pa TVSH, me TVSH bëhet 6 € muaji për ekonomi familjare, d.m.th.30% në 2 kategoritë e para , 25% në kategoritë e dyta. Ferizaj e ka aprovuar tarifën 6.5 euro me të njëjtën kompani, por ne e kemi analizuar se për komunën tonë është shumë tarifa 6.5€. Të çështja e parkingut, krahas gjenerimit të hyrave, ka shpenzime, 2 punëtorë janë për mirëmbajtje të hapësirave publike, 4 punëtorë i ka ekstra për vendosjen e tiketave. Ka nevojë edhe për punëtorë tjerë në parking, por nuk ka të interesuar me punuar me pagë 300€.

z. Naim Beça; Pyetja është: A ka profit kompania që i ka marrë në menaxhim parkingjet dhe sa është profiti ? Në mbledhjen vijuese mundesh me sjellë një raport për këtë çështje.

z. Ramadush Osmani: Nuk ka problem sa i përket çështjes së raportit që po kërkon sesa është profiti i kompanisë nga koha kur i ka marrë në menaxhim parkingjet, por çështja është se është problem me punuar me 2 raunde, se është menduar me punuar, po është problem dhe profiti nuk është ashtu siç është menduar, për shkak se ku ka frekuentim të veturave, nuk ka punëtorë se nuk ka të interesuar, sepse me u punësuar në kompani duhet lidhur kontratë dhe kontrata ua pamundëson me marrë ndihmën sociale.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime tjera nuk ka, Propozim Rregulloren e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me 18 votë Për, Kundër 6, Abstenoj 1. Pjesëmarrës në votim 25. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i komunës e ,

APROVOJ

Rregulloren për ndryshim plotësimin e Rregullores 01Nr. 02-60/01-4863/20 datë 06.07.2020 për Taksat Komunale / Lënda: 01Nr. 60/01-25563/22.

4. Propozim Vendimi për Transferin e mjeteve buxhetore;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Desha një sqarim nga drejtori të pika 1. Të shërbimet sociale, kodet nga barten dhe ku shkojnë ?

z. Bahri Selimi: Sivjet i kemi në buxhet 200,000€ për funksionalizimin e objektit social të banimit, 2 herë janë tenderuar, deri tani nuk kemi kontratë të tenderimit. Meqë jemi në fund të vitit, me lejon ligji me i tërhequr 15% të këtyre mjeteve, që i bien 29,900 €. Kemi kontratë për rrugë të Drejtorisë e Urbanizmit për shtrimin dhe asfaltimin e rrugëve lokale, mirëpo është nevojë imediate, kemi shumë aktivitete të grupeve sportistëve, kemi paraparë 9,900 € për blerje të agregatit të palestra sportive. Nuk ka rritje apo zvogëlim të buxhetit, por kemi lëvizje të mjeteve prej një kodi në kod tjetër.

z. Adnan Reka: Ju në vend se t'i rrisni investimet kapitale, ju çdo herë përmes transferit të mjeteve financiare i zhvendosni nëpër nën programe që kurrë nuk përfundojnë. (në mars 2021, kishte ndodhur e njëjta gjë) Me të vërtetë është e turpshme të kërkonin ende mjete për ndërtesën për banim social. A është kjo ndërtesë që po e arrin çmimin e ndërtimit mbi 600,000€, pa e paguar tokën për ndërtim. A është kjo ndërtesë ende e pa përfunduar, që në kohë fushate i mashtruat qytetarët e shkretë duke formuar Komisionin për ndarjen e banesave sociale, ndërsa tani po del të jetë ende e pa përfunduar. Të paktën përfundimisht na thoni, edhe sa kohë, dhe para ju nevojiten për ta kompletuar këtë ndërtesë, sepse kam frikë se kështu ju do ta bartni deri në fushatën e vitit 2025.

Kryetari i Komunës: Ndërtesa ka përfunduar, jemi duke pritur KEK-un se për me ndërtuar trafon, atëherë nuk është paraparë nga ministria.

z. Adnan Reka: A keni me dhënë mjete për trafon dhe a po e konsideroni se është bërë pak e tepërt ndërtimi i kësaj banese nga viti 2017, se është bërë shumë edhe në fushatë elektorale kujt me ia dhënë këto banesa, ndërkaq banesa ende nuk ka përfunduar.

Kryetari i Komunës: Po me vjen keq që nuk po e thoni një të vërtetë, unë asnjëherë kam bërë fushatë elektorale për çështjen e banesës së banimit social. Ma tha vetëm një individ kujt i kam porënduar në fushatë 1 person për me ia dhënë banesë. Me bien vetëm një mesazh para 27 anëtarëve këtu nëse Besim Ilazi ka përmendur ndonjë person se ka me iu dhënë banesë. Për atë kam kërkuar që komisioni për ndarje të banesave të banimit social të jetë nga subjektet e partive politike. Komisioni është formuar në KK dhe na e ka kthyer MAPL se nuk është në kompetencë të KK formimi i këtij komisioni dhe e kemi shfuqizuar dhe KK e ka shfuqizuar.

Kryesuesi i Kuvendit: Projekti i banesës sociale është projekt i realizuar në bashkëpunim me ministrinë. Komisioni është formuar në KK, vendimi është kthyer nga ministria për shkak se është në kompetencë të kryetarit formimi i komisionit dhe e kemi shfuqizuar. Kryetari ka kërkuar nga subjektet politike me sjellë ka një emër për anëtarë të komisionit për ndarje të banesave, a ju keni përgjigjur apo jo kërkesës së kryetarit, unë nuk e di dhe nuk mundesh me akuzuar askënd për diçka që nuk ka ndodhur.

z. Adnan Reka: Në komision ka qenë nga LVV Kaltrina Tafili, ndërkaq ne e kemi refuzuar me pas anëtarë të komisionit me vendim të kryetarit, janë procesverbalet, se paraprakisht i kemi thënë kryetarit se po e bënë këtë për fushatë politike se MAPL të kthen.

Kryetari i Komunës: Me pas dashur me formuar komision, nuk e kishe kuptuar fare, se është e drejtë e imja ekskluzive me formuar komision.

z. Agim Mani: Shuma prej 29.900€, a janë këto mjete në planifikimin buxhetor që e votuam tani se ne e votuam buxhetin me 200.000€, tani po ia tërheqim 29.2000 €.

z. Bahri Selimi: Këto mjete janë me buxhetin e vitit 2022 e jo në vitin 2023.

Kryesuesi i Kuvendit: Buxheti i vitit 2023 veç sa u votua dhe nuk mundemi t'i heqim mjete. Këto mjete janë të vitit 2022. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë Propozim Buxhetin e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me 15 votë për, Kundër 6, Abstenuan 4. Pjesëmarrës në votim 25. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për Transferin e mjeteve buxhetore / Lënda: 01Nr. 60/01-25464/22.

5. Propozim Vendimi për lejimin e mjeteve për subvencionim të fermerëve;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim për aprovim Propozim Vendimin dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Pjesëmarrës në votim 25. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për lejimin e mjeteve për subvencionim të fermerëve / Lënda: 01Nr.08-320/01-25452/22.

6. Propozim Vendimi për themelimin e Muzeut të Qytetit të Kaçanikut;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

znj. Ardita Rrahmani: Është për me u përshëndetur iniciativa e disa individëve për themelimin e Muzeut, meqë ka qenë premtim elektorale i kryetarit dhe secilit kandidat për kryetar. Pas 20 vjetëve me gjasë u kuptua se jemi shumë vonë me themelimin e muzeut, pasi që komuna e Kaçanikut është një ndër komunat në Kosovë që nuk ka muze. Komuna e Kaçanikut ka histori të lavdishme jo vetëm nga lufta e fundit por shumë herët, kështu që reliktet dhe gjithçka që kemi, kanë filluar me u vjetërsuar nuk kemi pasur ku me i ruajtur. Ne si LDK pos që e përgëzojmë këtë çështje do të votojmë Për themelimin e këtij muzeu, vetëm se nuk e lënë me diskutuar ato që i potencova në KPF. Ne jemi për themelimin e muzeut, por jo edhe për lokacionin, dhe hapësirën e vogël, që u tha 120m², uroj të gjendet një lokacion i përshtatshëm për shtëpi muze, besoj se do të votohet njëzëri, ndërkaq uroj të mos mbetet vetëm në letër si çështja e teatrit, e tërheqë këtë paralele duke ditur se edhe teatri edhe muzeu kanë kosto të madhe financiare, të fillohet në hapjen e muzeut.

z. Agim Mani: Ashtu siç e potencoj edhe Ardita, jemi e vetmja komunë që nuk kemi muze, kjo çështje është e mirëpritur dhe mirëseardhur, se deri tani nuk kemi arritur me pasur muze, për arkivimin, selektimin, ruajtjen dhe promovimin e relikteve dhe dokumenteve tjera të trashëgimisë të komunës tonë. Ne si komunë kemi një histori të gjatë të shumë periudhave të hershme, kemi Kushtetutën e Republikës së Kosovës, luftën e freskët të UÇK, dhe periudhat tjera historike. Kjo iniciativë e qytetarëve dhe shoqatave të dala nga lufta, për themelimin e Muzeut të Qytetit të Kaçanikut, është adresuar në DKRS, tani lëndën e kemi në KK, është mirë që kjo drejtori të bashkëpunoj ngushtë me drejtoritë tjera se atë të financave për përkrahje financiare. Në vitin 2023 shihet se nuk janë planifikuar mjete për këtë dhe nuk ka ndarë kod buxhetor për ndërtimin dhe rivilatizimin e monumenteve kulturore historike, kur dihet se përpos lokacionit që ka caktuar kjo drejtori, në start i nevojitet grumbullimi, bartja, vendosja e

këtyre monumenteve kulturore historike, restaurimi etj. me çka kjo ka kosto financiare dhe nëse nuk ka buxhet, do të jetë vështirë e realizueshme. Muzeu i qytetit duhet të gjej zbatim në nivel lokal dhe qendror, dhe mos të mbetet si çështja e teatrit, të cilin e kemi votuar në legjislaturën e kaluar KK, por nuk ka gjetur zbatim. Ne si LVV do të përkrahim themelimin e Muzeut të Qytetit të Kaçanikut dhe do të votojmë Për.

z. Naim Beça: Desha t'iu falënderoj të gjithëve për këtë iniciativë. Me vjen shumë mirë për këtë projekt, se Komuna e Kaçanikut ka histori, por nuk kemi pasur ku me treguar historinë tonë. Realizimi i këtij projekti është çështja me e rëndësishme që do të bëjë kjo komunë. Unë nuk jam jurist dhe nuk e di qysh shkojnë procedurat për realizimin e këtij projekti. Kërkoj që në buxhetin e komunës të ndahet një kod i veçantë buxhetor për çështje të këtij muzeu, për arsye se ka shumë artefakte dhe ka mundësi që njerëzit nuk i japin, por i shesin. Prandaj si komunë ne duhet me pasur buxhet solid se artefaktet janë shumë të shtrenjta. Pavarësisht çmimit, ne nuk duhet tërhequr për mos me blerë artefaktet, se ne jemi duke e bërë institucionin muze për fëmijët tanë, se muzeu mbetet e pasardhësit tanë duhet ditur historinë tonë, kështu që mos të kursehem për çështje buxheti. Kërkoj që të gjithë të angazhohemi e sidomos ne anëtarët e KK me bërë sa me publike këtë çështje, se kemi ndoshta sende në shtëpi të cilat mendojmë se janë të pavlerë, kështu që me i sjellë dhe me i vlerësuar të muzeu. Ju falënderoj shumë për këtë iniciativë, unë votoj Për.

znj. Kadrije Lika-Troni: Duke ditur se muzetë janë hapësira që bashkojnë të kaluarën me të ardhmen, roli kryesor i tyre është edukimi i komuniteteve. Qyteti ynë është i pasur me histori, mirëpo deri me tani i mangët për një objekt kulturor ku do të ruhej trashëgimia kulturore e Kaçanikut tonë legjendar. Ne si grup parlamentar i LVV falënderojmë iniciativën qytetare dhe mbështetim kërkesën për këtë iniciativë të qëlluar, falënderoj edhe shoqatat e dala nga lufta e UÇK që i dhanë rëndësi kërkesës për themelimin e muzeut të qytetit tonë. Ne si LVV jemi angazhuar vazhdimisht dhe në disa seanca në vazhdimësi kemi kërkuar se ku arritur kërkesa për themelimin e muzeut. Edhe pse me vonesë morëm përgjigje nga drejtoria përkatëse, ne mbështesim dhe thërrasim edhe kolegët tjerë që ta përkrahin propozim vendimin për themelimin e Muzeut të Qytetit të Kaçanikut.

z. Agim Çaka: Drejtoreshë, unë të kisha thënë me iu thënë drejtorëve tjerë me qëndruar këtu për me pa se kur të bëhen punë të mira, ne i përkrahim të gjithë. Kërkoj nga drejtoresha me na treguar kah arriti kjo ide që nuk është arritur me u bërë që 20 vjet ky projekt kaq i madh. Është një arritje mirë, ndërkaq lokacioni të shtëpia e kulturës nuk është mirë me qenë vendimtare, se është fjala një projekt të rëndësishë së veçantë. Është mirë një debat publik me u organizuar për këtë çështje, sepse nëse fjala vjen Ferizaj ka arsye me pasur një muze historik, atëherë Kaçaniku i ka 100 herë arsyet më të mëdha sesa Ferizaj, pasi kemi çka me paraqitur, kështu që duhet menduar për objekt atraktiv- shtëpi muze të këtij institucioni që kishte me sjellë edhe vizitorë. Të përgëzoj drejtoreshë për këtë arritje dhe të gjitha ata që kanë dhënë kontribut për këtë çështje, dhe po e theksoj edhe një herë, me vullnetin e mirë për punë të mira gjithmonë na keni pran të gjitha.

z. Adnan Reka: Të gjitha fjalët e mira veç u thanë për këtë projekt, kështu që e konfirmoj se ne LVV do të votojmë Për.

Kryesuesi i Kuvendit: fjalën e ka drejtoresha e cila e ka dhënë një angazhim të madh në këtë drejtim në nivel qendror dhe lokal me struktura të komunës dhe OJQ, një falënderim dhe mbështetje për fjalët e mira që u thanë.

znj. Hafize Sallahi: Faleminderit për komentet e fjalët e mira që po i adresoni tek unë. Të pyetja e Agimit lidhur me idenë, ideja ishte e kamotshme, mirëpo nuk kanë qenë të plotësuara kushtet. Unë kohë me parë me vendim të kryetarit e kam marrë këtë iniciativë, kam shqyrtuar edhe kërkesën e iniciativës qytetare, ata e patën propozuar një lokacion në sallën 7 Shtatori, mirëpo ai lokacion është në mbrojtje të monumenteve kulturore historike dhe nuk kemi guxuar me caktuar aty me mbledhur artefakte, e kemi pa të arsyeshme përkohësisht në objektin e shtëpisë së kulturës, në anën e djathtë në hyrje të shtëpisë së kulturës, është 2 pjesësh me një shkallë lëvizëse, sipërfaqja 120m². Kemi pasur takime të vazhdueshme me Muzeun kombëtar të Kosovës, kanë qenë edhe këtu në vizitë profesionistë të kësaj lëmi, dhe na i kanë dhënë pëlqimin fillimisht me filluar si muze duke vazhduar me i vendosur artefaktet e komunës tonë, por do të shqyrtojmë mundësinë pastaj për lokacion për një shtëpi muze. Me dokumente jemi në rregull, do të bëjmë thirrje publike qytetarëve për sjellje të artefakteve, kemi edhe arkeolog që kanë shprehur vullnetin me u angazhuar në këtë drejtim, edhe nga historian dhe me ndihmën e tyre dhe të juaj, kjo çështje do të shkoj përpara, por jo në një afat të shkurtër.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë pikë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Pjesëmarrës në votim, 25 anëtarë. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për themelimin e Muzeut të Qytetit të Kaçanikut / Lënda: 01Nr.09-60/01-25460/22.

Mbledhja i përfundoi punimet në ora 13:23. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët (25) që morën pjesë në këtë mbledhje.

Procesmbajtëse
Makfire Malsiu

Kryesues i Kuvendit
Kemal Murseli



Komuna e Kaçanikut

01-Nr. 430/03-2255/22
13.10.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme nenit 9, bazuar në Statutin e Komunës së Kaçanikut, Kryetari i Komunës së Kaçanikut në ,
nxjerr këtë:

PROPOZIM VENDIM

- për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2023

Neni 1 Normat Tatimore

Në zbatim të Ligjit Nr. 06/L-005, për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 9, paragrafi 1, nën paragrafët 1.1 deri 1.9, Kuvendi Komunal i Komunës së Kaçanikut cakton normat tatimore për vitin 2023 për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë pronë publike, si vijon:

- Për njësitë bujqësore të parcelave----- (0.15%)
- Për njësitë bujqësore të objekteve----- (0.15%)
- Për njësitë pyjore të parcelave----- (0.15%)
- Për njësitë rezidenciale të parcelave----- (0.15%)
- Për njësitë rezidenciale të objekteve----- (0.15%)
- Për njësitë komerciale të parcelave----- (0.18%)
- Për njësitë komerciale të objekteve----- (0.18%)
- Për njësitë industriale të parcelave----- (0.18%)
- Për njësitë industriale të objekteve----- (0.18%)

Neni 2 Zbatimi

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Ekonomi, financa e zhvillim dhe Zyra e Tatimit në Pronë.

Neni 3 Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi 8 ditë pas miratimit nga ana e Kuvendit Komunal dhe do të filloj së zbatuari nga 1 janari 2023.



Kryetari i Komunës
Besim Ilazi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



I	Data	03.11.22	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.	Numri		Shtojcë	
	01	106/02-26050		X

KAÇANIKU



Komuna Kaçanik

**PLANI I VEPRIMIT PËR PARANDALIMIN E DHUNËS NË
FAMILJE - MEKANIZMIT
(2023 – 2025)**

Tetor 2022

Lajmërimi i rasteve të dhunës në familje

Kontaktet:

Policia e Kosovës – Kaçanik - 192

Qendra për Punë Sociale – Kaçanik – 03820046416

Thirrjet emergjente - 122

Falënderim

Hartimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje ishte përpjekje e përbashkët e Grupit Punës për hartimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, nën koordinimin e ZBGJ, me përkrahjen e misionit të OSBE në Kosovë dhe një spektri të gjërë të partnerëve.

Komuna e Kaçanikut gjithashtu vlerëson lartë punën dhe përkushtimin e zyrtarëve në kuadër të ZBGJ, QKMF, QPS, OJQ-ve, Gjykatën dega në Kaçanik, Këshillin e Bashkësisë Islame - Kaçanik Policia e Kosovës. Po ashtu, falënderon veçanërisht institucionet komunale për kontributin që kanë treguar, se vlerëson me prioritet masat për parandalimin e dhunës në familje: Drejtorinë e Arsimit, Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (DSHMS).

Në zhvillimin e strategjisë kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm përfaqësuesit e institucioneve lokale dhe shërbimeve regjionale, duke ndihmuar që objektivat dhe masat e planifikuara të jenë të përafëruara me standardet dhe normat ndërkombëtare për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje.

Strategjia dhe Plani i Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje është një prej dokumenteve më të rëndësishme të Komunës së Kaçanikut hartimi i së cilës ka ndjekur një proces të gjatë diskutimesh dhe kontributesh konkrete të shumë institucioneve relevante që punojnë në këtë fushë. Përfshirja dhe kontributi i tyre kanë dhënë frytin e punës që gjendet në faqet e këtij dokumenti për parandalimin e dhunës në familje në komunën tonë.

Shkurtesat:

BE - Bashkimi Evropian

DKA – Drejtoria Komunale e Arsimit

DHBGJ - Dhuna në Baza Gjinore

DHF - Dhuna në familje

MAPL - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

MM - Memorandum mirëkuptimi

MV - Mbrojtës i Viktimave

OJQ - Organizata Joqeveritare

OSBE - Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë

PK – Policia e Kosovës

PSV - Procedurat standarde të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje

QAP - Qendra e aftësimit profesional

QMF – Qendra e Mjekësisë Familjare – Kaçanik

QPS - Qendrat për Punë Sociale - Kaçanik

QRK – Qeveria e Republikës së Kosovës

UA - Udhëzim Administrativ

ZKBGJ - Zyrtarët Komunalë për Barazi Gjinore

ZPK – Zyra e Punësimit – Kaçanik

Përmbajtja

I. Përmbledhje ekzekutive

II. Hyrja

III. Metodologjia

IV Sfondi –Analiza e gjendjes

4.1. Analiza e përgjithshme e situatës së dhunës në familje

4.2. Analiza e situatës së dhunës në familje në Komunë

4.3. Pasojat më të theksuara të dhunës në familje

V. Objektivat Strategjike

VI. Plani i Veprimit

VII. Aranzhimet e zbatimit, monitorimit dhe raportimit

7.1. Mekanizmat zbatues

7.2. Mekanizmat monitorues dhe raportues

I. Përmbledhje ekzekutive

Dhuna në familje është vepër penale¹ dhe fenomen që lëkund vlerat e shoqërisë demokratike. Kushtetuta e Republikës së Kosovës² në kuadër të parimeve të saj, mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, duke i konsideruar ato si të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme.

Me qëllim të parandalimit dhe ngritjes së efikasitetit të trajtimit të rasteve të dhunës në familje, duke synuar plotësimin e standardeve për ofrimin e mbrojtjes së duhur viktimave të dhunës në familje, në pajtim me Konventën e Stambollit, është hartuar Ligji për Mbrojtje nga dhuna në

¹ Kodi nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës, neni 248;

² Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kapitulli II;

familje, që “dhunën në familje”³ e përkufizon: “veprim apo mosveprim i qëllimshëm që rezulton me abuzim, kur kryhet nga një person që është apo ka qenë në marrëdhënie familjare me viktimën”.

Duke u bazuar në obligimet që rrjedhin nga korniza ligjore dhe standardet ndërkombëtare, mbështetur në masë të gjerë në Strategjinë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje/politikat nacionale dhe Programin e Kosovës për Barazi Gjinore (2020 – 2024), që njëherit paraqet një vazhdimësi logjike të përkushtimit të institucioneve qeveritare për një zgjidhje funksionale dhe efektive për parandalimin dhe luftimin e dhunës në familje dhe eliminimin e pabarazive e shtrirë në nivel lokal, Kuvendi Komunal Kaçanik nën koordinimin e Mekanizmit Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, me përkrahjen e OSBE në Kosovë ka hartuar “Strategjinë Komunale dhe Planin e Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje”.

Duke dënuar të gjitha format⁴ e dhunës në familje dhe bazuar në jetësimin e parimit të Kartës së Kombeve të Bashkuara “*Të drejta të barabarta për burrat dhe gratë*”⁵, strategjia është e përqendruar në fuqizimin dhe funksionalizimin e Mekanizmit Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, në përputhje me përgjegjësitë e tyre të përcaktuara në kuadër të Marrëveshjes së Mirëkuptimit⁶, kornizës ligjore në fuqi dhe obligimeve që rrjedhin nga Konventa e Stambollit për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, duke synuar rritjen e koordinimit efektiv dhe bashkërendimin e veprimeve në minimizimin e fenomenit të dhunës në familje dhe mbrojtjen e viktimës së dhunës.

Synim ky që parashihet të realizohet duke adresuar me prioritet fushat e veprimit të strategjisë:

Përmirësimi i sistemit institucional për parandalim dhe ofrim të shërbimeve cilësore për mbrojtje nga dhuna në familje;

Përmirësimi i qeverisjes lokale për parandalimin dhe mbrojtje nga dhuna në familje;

Fuqizimi i shërbimeve rehabilituese dhe riintegruese të viktimave të dhunë në familje;

Qasja strategjike e të cilit është që me anë të objektivave të qarta dhe aktiviteteve specifike, të ndihmojë Mekanizmin Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në fuqizimin e tyre për përmbushjen e përgjegjësisë institucionale karshi institucioneve që përfaqësojnë në këtë trup institucional dhe përgjegjësisë që rrjedhin themelimi i tyre. Njëherit, kërkon sigurimin e zbatimit të kornizës ligjore, politikave nacionale dhe standardeve ndërkombëtare për parandalimin, identifikimin pro-aktiv dhe luftimin e dhunës në familje, si dhe reagimit të menjëhershëm dhe të

³ Ligji nr. 03/L-182 për mbrojtje nga dhuna në familje, Kuvendi i Kosovës, neni 2.1(1.1): E definon si të tillë mes personave që janë/kanë qenë: të fejuar, të martuar; në bashkësi jashtëmartesore; bashkëjetojnë në ekonomi të përbashkët, si dhe përdorin një shtëpi të përbashkët dhe janë në lidhje gjaku, martesë, adoptimi, krushqie apo janë në lidhje kujdestarie, duke përfshirë prindërit, gjysherit, fëmijët, nipat, vëllezërit dhe motrat, hallat e tezet, xhaxhallarët e dajallarët ose kushërinjtë, janë prindër të një fëmije të përbashkët, janë palë procedurale në një kontest nga marrëdhëniet familjare: <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2010-182-eng.pdf> 2;

⁴ Dhuna në familje, dhuna fizike, psikologjike, seksuale dhe ekonomike, për nevojat e kësaj strategjie do të jetë e njëjtë siç është përkufizuar në dispozitën e nenit 2, nën paragrafi 1.2. të Ligjit nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje;

⁵ OKB, Karta e Kombeve të Bashkuara, neni 1, 1945;

⁶ Marrëveshje Mirëkuptimi për Institucionalizimin e Mekanizmit Koordinues Kundër Dhunës në Familje dhe Mënyrën e Funksionimit të të tij, në Komunën _____ më datë _____;

vazhdueshëm në ofrimin e shërbimeve cilësore për mbrojtje dhe trajtim të rasteve të dhunës në familje. Po ashtu, synon që duke marrë masa efektive në rritjen e koordinimit dhe bashkërendimit të veprimeve në mes të akterëve relevantë, të nxitet përparimi shoqërorë ku shoqëria është e vetëdijshme dhe mbështetëse e të drejtave të njeriut për të qenë të lirë nga të gjitha format e dhunës që promovon fuqizimin social dhe ekonomik të vajzave dhe grave dhe dhuna në familje të bëhet e papranueshme në komunitetin tonë.

Bazuar në frymën e Konventës së Stambollit që pranon se dhuna gjinore ndaj grave përbën “shkelje të rëndë të të drejtave të grave dhe vajzave dhe pengesë kryesore për arritjen e barazisë midis burrave dhe grave”⁷, strategjia në brendësinë e saj përfshinë perspektivën gjinore duke përcaktuar masa konkrete në kuadër të planit të veprimit për fuqizimin e gruas dhe arritjen e barazisë midis burrave dhe grave.

Të bindur se investimi në kapital njerëzor nuk është vetëm gjëja e duhur për të bërë nga pikëpamja etike dhe morale, por është gjithashtu gjëja më e mençur të bëhet nga pikëpamja ekonomike për njerëzit, familjet e tyre, komunitetin, shoqërinë dhe shtetin në përgjithësi. Në këtë kuptim, strategjia adreson edhe parimet dhe dimensionet e traktateve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, veçanërisht të Konventës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, si:

dinjiteti njerëzor⁸;

barazia në mes grave dhe burrave⁹;

mos-diskriminimi¹⁰;

moskthimi¹¹;

duke kërkuar që jetesat në komunitet të zhvillohet bazuar në respektimin e shtetit të së drejtës, të drejtave të njeriut, të drejtave të barabarta për burra dhe gra dhe respektimin e demokracisë.

Strategjia dhe Plani i Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje për Komunën e Kaçanikut, mundëson edhe koordinimin e përpjekjeve ekzistuese të të gjitha departamenteve dhe institucioneve qeverisëse komunale dhe të organizatave joqeveritare, duke angazhuar struktura të ndryshme publike dhe private, për të diskutuar dhe zgjidhur çështjet të ndryshme si ato të arsimit, shëndetit, shërbimeve sociale, punësimit, drejtësisë, familjes, fëmijëve dhe të moshuarve, etj.

Me zbatimin efikas të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje Komuna Kaçanikut do të fuqizojë dhe rrisë efikasitetin e mekanizmave institucional për mbrojtje,

⁷ Këshilli i Europës, Konventa për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, preambula, 2011;

⁸ OKB, Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, preambula 1948;

⁹ Këshilli i Europës, Konventa për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, preambula, neni 4.2, 2011;

¹⁰ Po aty, neni 4.3;

¹¹ Po aty, nenet 59-61, “kërkon që gratë viktime të dhunës në familje, pavarësisht nga statusi ose vendbanimi i tyre, nuk do të kthehen në asnjë vend ku jeta e tyre do të ishte në rrezik ose ku ato mund t’i nënshtrohen torturës, apo trajtimit çnjerëzor ose degradues”.

parandalim, ndjekje penale dhe eliminim të dhunës në familje, vetëdijesimin e shoqërisë për të sfiduar sjelljet e dhunshme duke besuar dhe mbrojtur qëndrimin se dhuna në familje kundrejt cilitdo anëtarë të saj është e pa-tolerueshme.

Dokumenti strategjik i referohet zbatimit të kuadrit ligjor kundër dhunës në familje në tërësi, i cili ndër të tjera thekson:

1. Të hartohen politika në nivel lokal për parandalimin, mbrojtjen dhe ofrimin e shërbimeve për viktimat dhe ushtruesit e dhunës në familje.
2. Mbështetja financiare e strehimoreve regjionale që mbështesin nëna me fëmijë, në proporcion me numrin e rasteve nga Komuna e Kaçanikut të strehuara si viktimat e dhunës në familje.

Përmbushja e obligimeve që rrjedhin nga strategjia do të kontribuojnë edhe në arritjen e synimeve nacionale të përcaktuara sipas Qëllimeve për Zhvillim të Qëndrueshëm në Kosovë (SDGs), që bëjnë thirrje për eliminimin e pabarazive (SDG 5)¹², objektiv kjo që synon eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave dhe vajzave, përfshirë trafikimin dhe format e tjera të shfrytëzimit si dhe eliminimin e të gjitha praktikave të dëmshme siç janë martesat e fëmijëve, martesat e hershme dhe të detyruara; si dhe promovimin e shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm (SDG 16)¹³ objektiv kjo që synon përfundimin e abuzimit, shfrytëzimit, trafikimit dhe të gjitha formave të dhunës ndaj dhe torturës ndaj fëmijëve dhe zvogëlimin e të gjitha formave të dhunës dhe vdekjeve të lidhura për të arritur një shoqëri paqësore dhe gjithëpërfshirëse.

Përmbushja e këtyre obligimeve dhe synimeve strategjike, do të mundësojë që Komuna Kaçanikut të shndërrohet në vend ku dhuna ndaj grave dhe në familje nuk tolerohet, reformimi i sistemit të mbrojtjes sociale të udhëheqet nga parimi i barazisë, si dhe të ndikohet në instalimin e filozofisë së inkurajimit të politikave sociale parandaluese, duke nxitur përparimin shoqërorë dhe qytetarisë demokratike në arritjen e vetëdijes më të lartë kolektive për barazi gjinore dhe të të drejtat e gruas të garantuar me konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, veçanërisht për Konventën e Këshillit të Europës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës Kundër Grave dhe Dhunës në Familje.

II. Hyrje

Ndonëse, dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje është shkelje e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut¹⁴ dhe përbën goditje të dinjitetit njerëzor, si në gjithë globin edhe në shoqërinë kosovare ajo vazhdon të jetë e përhapur me përmasa mjaftë të mëdha.

¹² Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave dhe vajzave;

¹³ Paqe, drejtës dhe institucione të forta;

¹⁴ Deklarata e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave, 1994;

<https://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/ViolenceAgainstWomen.aspx>, qasur më 1 korrik 2021;

Dhuna ndaj grave është manifestim i marrëdhënieve historikisht të pabarabarta të pushtetit midis burrave dhe grave¹⁵ dhe me të drejtë konsiderohet pengesa më madhe në realizimin e një bote paqësore, të prosperuar dhe të qëndrueshme. Krahas vështirësive ekonomike, shoqëria jonë po ballafaqohet edhe me një sërë problemesh tjera si: papunësia, lëvizjet demografike, ndryshime të koncepteve mbi vlerat dhe virtytet njerëzore, të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti në pjesëmarrjen e ulët të gruas në vendimmarrje dhe pabarazisë gjinore.

Duke qene se dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje gjithnjë e më shumë po njihet jo vetëm si shkelje e të drejtave individuale, por edhe si kërcënim për demokracinë, pengesë për zhvillim shoqëror dhe rrezik për paqe të qëndrueshme, pasojat e së cilës tronditin jo vetëm rrethim e ngushtë të familjes por të gjithë shoqërinë, dhe si e tillë kërkon angazhim të gjithë shoqërisë për marrjen e masave të nevojshme për parandalimin dhe luftimin e dhunës në familje, misioni i OSCE në Kosovë mori iniciativën të përkrahë Mekanizmin Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në hartimin e Strategjisë Komunale dhe Planin e Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (2023- 2025).

Para së gjithash, Strategjia do të ndikoj në rritjen e bashkëpunimit në mes të qytetarit dhe institucioneve shtetërore, shtyllat e së cilës janë të vendosura në “parandalimin e dhunës, mbrojtjen e viktimave të saj dhe ndjekja penale e dhunuesve”. Ajo synon gjithashtu të ndryshojë mendësitë e individëve duke iu bërë thirrje pjesëtarëve të shoqërisë, në veçanti burrave dhe djemve, të ndryshojnë sjellje.

Po ashtu, me anë të dokumentit strategjik synohet të vendoset një kornizë gjithëpërfshirëse dhe e unifikuar e përpjekjeve institucionale në kuadër të reformimit të sistemit për mbrojtjen nga dhuna në familje. Masa këto që i referohen fuqizimit të mekanizmave koordinues për reagim dhe bashkëpunim të shpejtë për parandalim dhe mbrojtje efikase të rasteve të dhunës në familje; promovimin e programeve dhe aktiviteteve për fuqizimin e grave, çrrënjosjen e paragjykimëve e stereotipeve si dhe pasojat e tyre; sigurimi i qëndrueshmërisë së shërbimeve për rehabilitim dhe riintegrim të viktimave të dhunës në familje.

Dokumenti strategjik identifikon çështjet që me prioritet kanë nevojë për ndërhyrje të menjëhershme duke kërkuar bërjen e përpjekjeve maksimale që të sigurohet “Një shoqëri që iu siguron të gjithë shtetaseve të saj, të rritur dhe fëmijë, të jetojnë pa frikë apo kërcënimin e dhunës në familje, që mbron viktimat, vendos kryerësit përpara përgjegjësisë dhe zvogëlon tolerancën e publikut ndaj veprimeve të dhunshme në familje”.¹⁶

Realizimi i të drejtave të njeriut, fillon me sigurimin e barazisë, rezultatet e të cilit janë të ndërlidhura në nivel të lartë të produktivitetit për ekonomin, gjendjen sociale dhe zhvillimin e vendit. Strategjia parashihet të jetë katalizatorë që duke përcaktuar hapat e mëtejme që duhet

¹⁵ Këshilli i Europës, Konventa për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, preambula, 2011;

¹⁶ Ministria e Drejtësisë, Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Plani i Veprimit (2016-2020), 2016;

ndërmerren drejt një strukture koherente për promovim, respektim, mbrojtje dhe luftim të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, të ndikoj në përshpejtimin e investimeve më të mira dhe të shtuara për të drejtat e njeriut për një barazi më të madhe dhe rritje ekonomike në vend. Për më tej, Strategjia në vete bënë edhe thirrje për aksion, që të bashkojmë dijet, energjinë, mundësit dhe financat, për realizim të plotë të të drejtave të njeriut, për të rritur mirëqenien dhe eliminimin e kohezionit social në Komunën e Kaçanikut.

III. Metodologjia

Strategjia për Mbrojtje nga Dhuna në Familje është hartuar duke u bazuar në një metodologji të kombinuar në mënyrë që të jetë gjithëpërfshirëse, të adresojë prioritetet kyçe bazuar në nevojën për ndërhyrje dhe të siguroj që aktivitetet e përcaktuara do të kontribuojnë në arritjen e objektivave strategjike.

Në aspektin strukturor dhe përmbajtësor "Strategjia për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (2021-2025) është hartuar në përputhje të plotë me Udhëzimin Administrativ (QRK) nr. 07/2018 për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit, Rregulloren e Punës së Qeverisë Nr.09/2011 dhe Rregulloren (QRK) Nr.05/2016 për Standardet minimale për procesin e Konsultimit Publik.

Hartimi i strategjisë është kryer përmes një procesi të gjatë pjesëmarrës, nën drejtimin e Komunës, drejtuesit më të lartë dhe stafet përgjegjëse të drejtorive të ndryshme përfshirë në proces, së bashku me të gjitha institucionet e tjera në nivel komunal. Janë organizuar një sërë takimesh të gjera për njohjen e situatës, hartimin e drejtimeve strategjike dhe planifikimin e aktiviteteve specifike sipas termave kohorë të kësaj strategjie.

Përgjatë procesit të hartimit të dokumentit strategjik janë organizuar punëtori me akterët relevantë në kuadër të Mekanizmit Komunal Koordinues Kundër Dhunës në Familje. Pjesëmarrës në punëtori ishin përfaqësues të: Policisë së Kosovës, Prokurorisë Themelore Ferizaj, Gjykatës Themelore dega në Kaçanik, Zyrës për Mbrojtje të Viktimave, Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, Drejtorisë Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Drejtorisë Komunale për Arsim, Qendrës për Punë Sociale, Zyrës për Barazi Gjinore, Qendra e Mjekësisë Familjare, Strehimore, Këshilli i Bashkësisë Islame në Kaçanik dhe sipas nevojës janë realizuar takime individuale me aktorët kyç institucional dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile.

Veprime këto që kanë shërbyer të pranohen pikëpamjet dhe kontributet e të gjithë përfaqësuesve në kuadër të Mekanizmave Koordinues Kundër Dhunës në Familje dhe akterët tjerë relevantë, duke i vënë në pah përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet eventuale, në përmbushjen e objektivave të dokumentit strategjik. Po ashtu, punëtorja ka shërbyer si mjet për të pranuar pajtueshmërinë e të gjithëve në përcaktimin e qëllimit, objektivave, aktiviteteve, rezultateve dhe treguesve të dokumentit Strategjik.

Përgjithësisht, procesi i hartimit të strategjisë ishte i ndarë në tri faza:

Faza e parë është karakterizuar me analizimin e situatës së përgjithshme, me ç'rast janë konsideruar dhe analizuar instrumentet dhe standardet ndërkombëtare, korniza ligjore vendore në fuqi, politikat dhe strategjitë për mbrojtje nga dhuna në familje, si dhe raporte, hulumtime e vlerësime të ndryshme, vendore e ndërkombëtare, të kryera së fundmi lidhur me fenomenin e dhunës në familje.

Faza e dytë është karakterizuar me realizimin e punëtorive dhe sesioneve individuale me aktorët kyç institucional dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Ndërsa, në fazën e tretë dokumenti i është nënshtruar procesit të konsultimeve publike, duke u siguruar që procesi i hartimit të dokumentit strategjikë është bërë i njohur dhe iu është dhënë mundësia për ofrimin e komenteve të gjithë akterëve institucional në nivel qendror dhe lokal, përfaqësuesve të OJQ, duke u siguruar që procesi i hartimit të dokumentit strategjikë është bërë i njohur dhe iu është dhënë mundësia për ofrimin e komenteve të gjitha palëve të interesit, duke synuar pjesëmarrje gjithëpërfshirëse në procesin e parandalimit dhe mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje në përputhje me interesin më të mirë të tyre.

Udhëheqësi i mekanizmit koordinues kundër dhunës në familje në bashkëpunim të ngushtë me anëtarët e mekanizmit nën përkrahjen e Misionit të OSCE në Kosovë, ka shqyrtuar, inkorporuar dhe validuar inputet e pranuar nga procesi i konsultimit publik dhe sipas legjislacionit në fuqi, dokumenti strategjikë është proceduar për aprovim në Kuvendin Komunal.

IV. Sfondi

4.1 Analiza e përgjithshme e situatës së dhunës në familje

Barazia gjinore është një parim i të drejtave të njeriut, andaj të drejtat e grave janë pjesë e patjetërsueshme, integrale dhe e pandashme e të drejtave universale të njeriut. Një jetë e lirë nga dhuna është një parakusht dhe një kërkesë themelore për një jetë të barabartë. Kur flasim për “mbrojtjen nga dhunën në familje”, Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me institucionet qeveritare në nivel qendror dhe lokal, veçanërisht Agjencinë për Barazi Gjinore, me përkrahjen e organizatave vendore e ndërkombëtare, si misioni i OSBE në Kosovë, ka arritë të zhvillojë nisma reformuese dhe avancime pozitive në kontekst të zbatimit praktik të kuadrit ligjorë duke adresuar standardet ndërkombëtare¹⁷.

¹⁷ Standardet e përcaktuara në “Rekomandim i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës CM/Rec (2007)/17 Rekomandim për standardet dhe mekanizmat e barazisë gjinore”;

Reforma këto që kanë ndikuar në zhvillimin e vullnetit politik dhe angazhimit institucional në përfshirjen e “barazisë gjinore” në qendër të politikave strategjike që ka rezultuar me hartimin e politikave dhe legjislacionit vendorë në përputhje me standardet ndërkombëtare, hartimin e programeve specifike për mbrojtje nga dhuna në familje dhe për barazi gjinore, marrjen e masave që synojnë të përmbushin nevojat specifike të grave dhe zhdukjen e zakoneve/praktikave që rezultojnë negativisht në gëzimin e plotë të të drejtave të njeriut.

Mirëpo, përfshirja e këtyre standardeve në agjendën e politikave institucionale nënkupton jo vetëm zotim për realizim të tyre, por marrjen e një sërë masash për përmbushjen e një numri të caktuar të kërkesave që duhet të shihen si tregues cilësorë të vullnetit politik për të arritur në thelb barazinë gjinore, për rrjedhojë edhe mbrojtjen nga dhuna në familje.

Bazuar në të gjeturat raporteve të monitorimit për mbrojtjen nga dhuna në familje, që njëherit pasqyrojnë situatën aktuale sa i përket barazisë gjinore në Republikën Kosovë duke ofruar informata mbi treguesit kyç të cilët janë në përputhje me kriteret e përcaktuara në legjislacionit vendor, Konventën e Këshillit të Europë për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje dhe Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm (të njohur si SDG), rezultojë se janë bërë përmirësime të ndjeshme duke evidentuar arritjet më të rëndësishme, përfshirë: zvogëlimin e qëndrimeve paragjyquese dhe sjelljeve që e mbështesin dhunën në familje; themelimin e mekanizmave koordinues në nivel qendror dhe lokal kundër dhunës në familje; rritjen e njohurive në mesin e profesionistëve që direkt ose indirekt punojnë për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje; lehtësimi i qasjes në shërbime dhe rritja e efikasitetit të tyre, për rehabilitim dhe riintegrim të viktimave të dhunës në familje. Të arritura këto, të cilat janë në hap me agjendën dhe përpjekjet globale për mbrojtjen nga dhuna në familje.

Megjithatë, mbetet ende shumë për t'u bërë për të përmirësuar përpjekjet e bashkërenduara institucionale në fuqizimin e mekanizmave për reagim të shpejtë, mbrojtje dhe trajtim të rasteve të dhunës në familje; për të siguruar mirëqenien e viktimave të dhunës në familje; rehabilituar dhe riintegruar viktimave të dhunës në familje duke ju siguruar mundësi të jetojnë të barabartë dhe me dinjitet; nxitjen e përparimit shoqëror duke mos e toleruar dhe justifikuar dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje; dhe vënien përpara përgjegjësisë, njëkohësishtë rehabilitimin e vazhdueshëm të kryesve të dhunës në familje.

Dhuna me bazë gjinore është shkelja më e rëndë nga shkeljet me të cilat përballen shumë gra dhe vajza. Pabarazia gjinore dhe dhuna ndaj grave janë ngushtë të ndërlidhura me njëra-tjetrën. Parandalimi i dhunës me bazë gjinore shpesh mbizotëron diskursin për pabarazinë gjinore, posaçërisht në shoqëritë më patriarkale, siç është Kosova. Vlerësohet se të paktën 12 gra vriten nga dhuna e lidhur me gjininë në Evropë çdo ditë. Ndërsa, në Kosovë një në çdo tre gra ka përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga partneri¹⁸.

¹⁸ UN Women, “Fakte dhe Shifra: Përfundimi i dhunës kundër grave një pandemi në formate ndryshme”, faqja e qasur më 22.7.2018. at: www.unwomen.org/en/ehat-ee-do/ending-violence-against-women/facts-and-figures;

Mbizotërimi i dhunës me bazë gjinore mbetet alarmant në Kosovë. Gjatë dhjetëvjeçarit të kaluar, ka pasur një rritje në numrin e raportuar të rasteve të vrasjeve që kanë rezultuar nga dhuna në familje dhe dhuna me bazë gjinore. Derisa mesatarja vjetore e rasteve të raportuara ndërmjet viteve 2002 dhe 2017 ishte 1.152, vetëm në vitin 2019 u raportuan 1.915. Përkundër rritjes së numrit të rasteve të raportuara të dhunës në familje, bazuar në përfundimet e sondazheve konkludohet se incidentet aktuale janë shumë më të larta, deri në 68% dhe se shumë raste mbeten të pa raportuara. Gjatë viti 2020 dhe veçanërisht gjatë kohës së masave të bllokadës për shkak të parandalimit të përhapjes së virusit COVID-19, sipas të dhënave të Policisë së Kosovës gjatë vitit 2020 janë raportuar, pothuajse, 650 raste të dhunës në familje në të gjithë vendin: 161 raste të raportuara në muajin janar, 151 në muajin shkurt, 169 në muajin mars dhe 167 në muajin prill.¹⁹

Ndërsa, reagimi i institucional për marrjen e masave të nevojshme dhe efektive për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe me bazë gjinore, rezultonë të jetë i dobët. Këtë e dëshmon edhe norma lartë e rasteve të hedhura poshtë të dhunës në familje, pasi gjatë vitit 2017 ishin më shumë se gjysma e të gjitha kallëzimeve penale të lidhura me rastet e dhunës në familje (51.5%) që ishin hedhur poshtë nga gjykatat e Kosovës. Për më tepër, gjatë gjashtë muajve të parë të vitit 2018, u hodhën poshtë gjithsej 15.1% raste. Për periudhën e monitoruar për 2015-2018, vetëm 40.4% e rasteve kanë marrë vendime të fajësisë. Kjo përgjigje e ngadaltë nga sistemi i drejtësisë penale ndaj rasteve të dhunës në familje ka çuar në shfaqjen e përgjithshme të mosndëshkimit për autorët e dhunës në familje. Për më tepër, viktimat që fajësohet dhe pajtimi i viktimës me kryerësin mbetet e zakonshme në mesin e të gjitha institucioneve të monitoruara, shpesh të justifikuara me qëllim të "shpëtimit" të familjes tradicionale²⁰. Për më tej, studimet vinë në përfundim se: gati një e treta e kosovarëve besojnë se në familje "dhuna është pjesë normale e çdo marrëdhënieje dhe shoqëria në përgjithësi pranon se dhuna mund të ndodhë ndonjëherë". Për më keq, një në tre kosovarë beson se dhuna në familje është "problem familjar, kështu që fqinjët nuk duhet ta raportojnë atë në polici"²¹.

4.2 Analiza e situatës së dhunës në familje në Komunën e Kaçanikut

Dhuna në Familje nuk është një dukuri e re për qytetarët e komunës sonë, por edhe shoqërinë kosovare në përgjithësi. E shprehur në formë dhe intensitete të ndryshme ajo është trashëguar prej së shkuarës, por në ditët e sotme vërehen edhe shumë tipare të reja të shprehjes së saj. Analiza e shkurtër e situatës në Komunën e Kaçanikut ka ndihmuar të qartësohet lista e problemeve dhe shkaqeve që i shkaktojnë ato. Shkaqet që çojnë në rritjen e shkallës së Dhunës në Familje janë të shumta, ndërmjet të cilave

¹⁹ <https://balkaninsight.com/> COVID-19 dhe dhuna në familje: Kur shtëpia s'është vendi më i sigurt, prill, 2020;

²⁰ KIPRED, Qasja në drejtësi e viktimave të dhunës me bazë gjinore në Kosovë: Përfundimi i mosndëshkimit të autorëve të krimit, 2018;

²¹ Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës, Mjaft më me arsye: Analiza e qëndrimeve, incidencës dhe reagimeve institucionale ndaj dhunës në familje në Kosovë, 2015;

përmendim:

Pabarazitë gjinore: Në Kosovë, roli i femrave në proceset e zhvillimit shoqëror, ekonomik dhe politik është shumë i rëndësishëm, ndonëse ende në ditët e sotme ndeshemi me pabarazi gjinore të dukshme apo të fshehura. Pozita e pabarabartë gjinore ndikohet nga shkalla e ulët e punësimit të grave, vështirësitë që kanë në qasje të shërbimeve shëndetësore, niveli i ulët i integritetit të grave në ekonomi dhe numri i vogël i grave në pozitat udhëheqëse në administratën publike.

Në Kosovë është krijuar një bazë e mirë ligjore sa i përket çështjes së barazisë gjinore dhe janë bërë hapa të dukshëm në avancimin e pozitës së grave, ku Komuna e Kaçanikut krahas viteve të mëhershme, ka shënuar progres të dukshëm në avancimin e gruas. Të dhënat paraqesin një përfshirje më të madhe të grave në politikë, në arsim, e sektorë të tjerë. Megjithatë, ende nuk është arritur përfaqësimi i kënaqshëm gjinor, i paraparë në Ligjin për Barazi Gjinore, në të cilin përcaktohet se pjesëmarrja e barabartë e femrave dhe meshkujve, në institucione apo në nivel të pushtetit.

Duke pasur parasysh trendet e shkallës së papunësisë, për një pjesë të popullsisë në Komunën e Kaçanikut, femra mbetet në pozitë më të pafavorshme krahasuar me meshkujt si në lëmin e punësimit, nivelit të varfërisë, arsimit, si dhe pjesëmarrjen aktive në sferën publike dhe private.

Pabarazitë gjinore në gjendjen ekonomike: Në Komunën e Kaçanikut ashtu si në tërë vendin, gjendja e vështirë ekonomike rëndon më shumë mbi femrat, të cilat kanë numrin më të madh të papunësuarve. Për vitin 2019, janë të regjistruara 799 familje në skemën e ndihmës sociale, në vitin 2020 kemi të regjistruara 802 dhe përgjatë 2021 kemi 816 familje .

Raste të dhunës në familje për 3 vite në komunën tonë pra raste të cilat janë lajmëruar sepse shifrat janë edhe më të mëdha

2019: 24 raste të dhunës në familje

2020: 16 raste të dhunës në familje

2021: 30 raste të dhunës në familje

Kurse kanë kërkuar strehim në strehimore për vitet 2019 – 2020-2021 në strehimoren – My Home 9 raste

Kaçanik	5	0	4
---------	---	---	---

My Home-Ferizaj	5 raste; 2 (gra), 2 (fëmijë) 1 djal dhe 1 vajzë.	Asnjë rast	4 raste; 2 gra dhe 2 fëmijë,
-----------------	--	------------	------------------------------

4.3. Pasojat më të theksuara të dhunës në familje

Dhuna në Familje sjell shumë pasoja në komunitet, të cilat kanë një numër të madh efektesh të padëshiruara:

Kriza familjare: Avancimi i rolit të femrës në shoqëri dhe pozita e saj në familje ka ndryshuar në kuptimin e pavarësisht më të madh të saj, marrjes së iniciativave, edukimit dhe arsimimit, fakte të cilat kanë ndikuar në ndryshimin e roleve në familje dhe shoqëri. Kriza familjare në periudhën e pas luftës në Kosovë ka shkaqe të ndryshme: lëvizja e popullatës nga fshatrat në qytete, kalimi nga familjet e zgjeruara dhe të mëdha në familje më të vogla. Të tilla ndryshime shihen si faktorë mbrojtës (kur shmanget ndikimi patriarkal prej brezave më të vjetër), por edhe faktorë rreziku njëherësh, si pamundësia e mbrojtjes në rastet e dhunës në familje të nxitura nga papunësia, konfliktet dhe mentalitetit mes gjeneratave, etj.

Frika dhe ndërgjegjësimi ulët për çështjet e dhunës në familje: Mos raportimi i dhunës në familje nga viktimat është ndër fenomenet më të shpeshta, pasi konsiderohet turp dhe një çështje që nuk duhet të dalë jashtë mureve të shtëpisë.

Mospranimi i dhunës seksuale: Për shkak të stigmës dhe ndëshkimit vërehet mos raportim i dhunës nga ana e viktimave dhe për këtë dhuna seksuale rezulton më pak e raportuar ose nuk ekziston fare në krahasim me dhunën fizike.

Probleme lidhur me trashëgiminë: Sa i përket procedurave të shqyrtimit të trashëgimisë, shumë herë ndodh që gruaja nuk njoftohet fare ose përjashtohet nga diskutimi për masën trashëgimore, qoftë në pozitën e bashkëshortes, nënës apo motrës dhe në këtë mënyrë diskriminohet. Veç kësaj, organi kompetent komunal për mbajtjen e librit amzë të vdekjeve ka për detyrë që në aktvdekje të shënojë emrat e trashëgimtarëve femra dhe meshkuj dhe asesi të mos i diskriminojë femrat

V. Objektivat strategjike

“Dhuna ndaj grave në thelb është çështje e pushtetit. Ajo do të përfundojë vetëm kur barazia gjinore dhe fuqizimi i plotë i grave do të behën realitet.” (Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, António Guterres)

Objektivat strategjike kanë pikë synim të kontribuojnë në arritjen e barazisë duke punuar në parandalimin e dhunës në familje, sepse një jetë e lirë nga dhuna është një parakusht dhe një kërkesë themelore për një jetë të barabartë.

Po ashtu, të rrisin ndikimin dhe dukshmërinë e standardeve ndërkombëtare dhe zbatimin e kornizës ligjore kombëtare për mbrojtjen nga dhuna dhe promovimin e barazisë gjinore, duke mbështetur zbatimin e tyre përmes një sërë masash që promovojnë ndryshimin në modelet shoqërore dhe kulturore të sjelljes së gra dhe burra.

Të sigurojë që vajzat trajtohen me respekt të plotë për dinjitetin dhe të drejtat e tyre duke promovuar mjedis pa dhunë në Komunën e Kaçanikut . Për të siguruar që profesionistët që ofrojnë shërbime themelore për mbrojtje të viktimave të dhunës në familje, kanë njohuritë e nevojshme për të integruar një perspektivë gjinore në politikat publike, si dhe marrjen e masave të nevojshme për parandalimin e dhunës në familje.

Strategjia komunale kundër Dhunës në Familje për Komunën e Kaçanikut synon të:

- ☐ Të punojë në parandalimin e dhunës në familje dhe ngritjen e vetëdijes tek komuniteti për aspektet negative të këtij fenomeni;
- ☐ Të përmirësojë/ndërtojë sistemin e grumbullimit dhe shkëmbimit të të dhënave në mes të akterëve relevant;
- ☐ Të fuqizojë mekanizmat për reagim sa më të shpejtë ndaj rasteve të dhunës në familje dhe të përmirësojë koordinimin në mes anëtarëve të grupit gjatë menaxhimit të tyre;
- ☐ Të bëjë avokim dhe monitorim të zbatimit të politikave si dhe të sugjerojë ndryshime bazuar në përvojat më të mira nga terreni.

Mbështetur në tri fusha të veprimit, si *“Vetëdijësimi dhe Parandalimi”*; *“Mbrojtja dhe Koordinimi”*; *“Fuqizimi ekonomik, rehabilitimi dhe riintegrimi”* me anë të adresimit të objektivave strategjike dhe specifike, si:

Objektiva Strategjike #1: Përmirësimi i sistemit institucional për parandalim dhe ofrim të shërbimeve cilësore për mbrojtje nga dhuna në familje:

Objektiva specifike #1.1: Ngritja e kapaciteteve të profesionistëve për parandalimin

dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje;

Objektiva specifike #1.2: Vetëdijesimi i opinionit publik për parandalimin dhe luftimin e

dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje;

Objektiva specifike #1.3: Inkurajimi i qytetarëve dhe viktimave të dhunës në familje për

raportimin e rasteve të dhunës në familje;

Objektiva Strategjike # 2: Përmirësimi i qeverisjes lokale për parandalimin dhe mbrojtje nga dhuna në familje:

Objektiva specifike # 2.1: Funksionalizimi i Mekanizmit Koordinues Komunal për

Mbrojtje nga Dhuna në Familje;

Objektiva specifike # 2.2: Fuqizimi i sistemit të raportimit dhe ankesave për mbrojtje

nga dhuna në familje;

Objektiva specifike # 2.3: Avancimi i monitorimi të politikave dhe obligimeve ligjore

për mbrojtje nga dhuna në familje;

Objektiva specifike # 2.4: Fuqizimi ekonomik i grave dhe viktimave të dhunës në

Familje;

Objektiva Strategjike # 3: Fuqizimi i shërbimeve rehabilituese dhe riintegruese të viktimave

të dhunë në familje:

Objektiva specifike # 3.1: Avancimi i shërbimeve rehabilituese për mbrojtje nga

dhuna në familje;

Objektiva specifike #3.1: Avancimi i shërbimeve riintegruese për mbrojtje nga dhuna në

Familje;

VI.Plani i Veprimit

FUSHA E VEPRIMIT – A. ELIMINIMI I PABARAZIVE GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE Deri në vitin 2025, strategjia lokale synon të ndryshojë qasjen në familje dhe shoqëri për eliminimin e pabarazisë gjinore dhe dhunën në familje					
Drejtimi strategjik	Aktivitet	K Koha e zbatimit Sipas shtyllave: Parandalim, Mbrojtje, Riintegrim Sipas kohës së zbatimit: ASH – Afat shkurtër, AM – Afat Mesëm; AGJ – Afat Gjatë	Indikator i suksesit	Institucion përgjegjës për zbatim	Kostoja buxhetore
A.1. Eliminimi i stereotipeve gjinore për luftimin e dhunës në familje	1.1 Fushata vetëdijësuese dhe kampanja informuese, vebfaqja komunës, rrjetet sociale, për publikun e gjerë në komunën e Kaçanikut	P+M+R ASH+AM	Prej rreth 31.000 banorëve , rreth 50% e tyre ta marrin mesazhin si dhe të jen bërë pjesë e aktiviteteve ndërgjegjësuese	QPS, Policia, Zbgj Komuna Dak OJQ-te QKMF	600 €
	1.2 Trajnimet për Barazi gjinore dhe dhunën në familje me përfaqësues të instucioneve vendore	P+M+R ASH+AM			500 €
A.2. Ngritja e vetëdijësimit të grave dhe të rinjve, institucioneve dhe bizneseve për pasojat e dhunës në familje dhe të pabarazisë gjinore.	2.1 Fushata (drama, me temë të barazisë gjinore dhe dhunës në familje, ligjërata, ese, dhe piktura) me të rinjtë; 2.2 Takime me gra dhe vajza në fshatra për të drejtat e tyre ligjore, me fokus në DHF, dhe lajmërimi i rasteve të DHF, gjatë takimeve do të shpërndahen informacione dhe fletëpalosje	P Aktivitet në vijimësi P Aktivitet në vijimësi	Rritja e përqindjes së grave dhe vajzave të ndërgjegjësuar nga 20% në 40%	Komuna Zbgj Dak Policia Ojq Donatorë QKMF	500 € 700 €

A.3 Hulumtimi dhe mbledhja e të dhënave dhe statistikave të dhunës në familje, në Komunën tonë.	Takimete e rregullta të mekanizmit kundër dhunës në familje dhe diskutimi i rasteve Krijimi i një databaze ndërinstitucional – mekanizmi	P+M+R AGJ AGJ	Mbshteja institucionale e mekanizmit Hulumtimi , ruajtja e të dhënave,	Komuna MKDHF OJQ QKMF Donatorë	500 €
A.4. Fuqizimi i rolit të gruas në shoqëri përmes promovimit dhe rritjes së numrit të femrave në pozicionet vendimmarrëse	3.1 Ndarja e përvojave të suksesshme të modeleve në takime me gratë dhe komunitetin	P AGJ	Rritja e përqindjes së grave pjesëmarrëse aktive në takime Rritja e përqindjes së grave në pozicionet vendimmarrëse nga 30% në 45%	Komuna Zbgj OJQ lokale MK, grupi i grave asambleiste	300 €

Deri në vitin 2025, strategjia lokale synon një komunitet të mirë informuar, edukuar në çështjet e dhunës në familje, me profesionistë të përgatitur për të parandaluar, njohur dhe kualifikuar për trajtimin adekuat të viktimave të dhunës në familje dhe të komunitetit në tërësi si dhe të kryerësve të veprave penale

Drejtimi strategjik	Aktivitete	Lidhja me Strategjinë Kombëtare dhe Koha e zbatimit	Indikator i suksesit	Institucioni përgjegjës për zbatim	Kostoja buxhetore
B.1 Ndërgjegjësimi i nxënësve dhe prindërve të AMU dhe AML për çështjet e dhunës në familje	1.1 Aktivitete informuese nëpërmjet mekanizmit kordinues, në kuadër të orëve mësimore dhe të fletëpalosjeve, broshurave, etj	P+M+R Aktivitet në vijimësi	Deri në vitin 2025, rreth 50% e nxënësve dhe prindërve janë të ndërgjegjësuar për LMDF dhe DHF	Mekanizmi kordinues Qps Zbgj Drejtoria e arsimit, QKMF, OJQ – të PK	1000 €
	1.2 Informimi i qytetarëve përmes ueb faqes se komunes, rrjeteve sociale	P Aktivitet në vijimësi			
	1.3 Aktivitete informuese dhe edukuese në kuadër të programit të aktiviteteve shkollore me pjesëmarrjen e nxënësve (orë mësimore, fushata, postera)	P ASH + AM			

B.2 Ngritja profesionale e mësimeve të edukatës qytetare lidhur me DHF dhe trajtimin e saj	2.1 mbajtja e ligjëratave në orën mësimore me temën dhuna në familje, dukurit negative në shoqëri nga mësuesit e edukatës qytetare.	P	Aktivitet në vijimësi	Deri në vitin 2025, 15% e orëve të edukatës qytetare do të kalojnë në tematika të DHF	Drejtoria e Arsimit Zbgj Komuna OJQ	150 €
	2.2 Organizimi i vizitave studimore për shkëmbimin e përvojave me vendet e rajonit dhe komunave	P AM				Donatorët
	3.1 Kryerja e hulumtimeve sociologjike mbi shkaqet kryesore të braktisjes së shkollës prej nxënësve të familjeve ku ushtrohet dhunë	P+M+R ASH		Deri në vitin 2025, ulet numri i nxënësve që braktisin shkollën prej DHF	Drejtoria e Arsimit Mekanizmi koordinues	
B.3 Ujja e numrit të nxënësve që braktisin shkollën e ulët dhe të lartë si rezultat i DHF, në zonat rurale.	3.2 Monitorimi i aplikimit të masave ligjore që sanksionojnë braktisjen e shkollës	P+M ASH+AM				

FUSHA E VEPRIMIT – C. FUQIZIMI I BAZËS EKONOMIKE

Deri në vitin 2025, strategjia lokale synon në parandalimin, mbrojtjen dhe rintegrimin përmes mbështetjes ekonomike dhe dhënien e mundësive për mirëqënien e të mbijetuarave të DHF dhe të familjeve të tyre si dhe kryerësve të veprës penale

Drejtimi strategjik	Aktivite	Lidhja me Strategjinë Kombëtare dhe Koha e zbatimit	Indikatori i suksesit	Institucioni përgjegjës për zbatim	Kostoja buxhetore
C.1 Fuqizimi ekonomik i viktimave të dhunës në familje në përkrahjen për punësim dhe vetëpunësim	1.1 Rregjistrimi, evidentimi dhe orientimi i viktimave të DHF pranë komunës dhe zyrës se punësim	Sipas shtyllave: <u>Parandalim</u> , <u>Mbrojtje</u> , <u>Rintegrim</u> Sipas kohës së zbatimit: ASH – Afatshkurtër, AM – AfatMesëm; AGJ – Afat Gjatë M+R AM	Brenda 3 viteve sistemi i rregjistrimit dhe orientimit bëhet funksional sipas standardeve kombëtare në përpunim		
	1.2 Ofrimi i këshillave në prezantimin e dokumentacionit për aplikim të suksesshëm sipas tregut të punës	M+R Aktivitete në vijimësi		Komuna ZPK Sipas përcaktimit të standartit kombëtar	
	1.3 Hartimi dhe aprovimi normave rregullative, përmes krijimit të politikave, për lirin nga taksat komunale në rastet e hapjes së një biznesi të ri	M+R ASH			

C.2. Mbështetje socio ekonomike të mbijetuarave të DHF si dhe strehimi i tyre	2.1 Ofrimi i trajnimeve për ngritjen profesionale, informacioneve për mundësitë për biznes	M+R Aktivitet në vijimësi	40% e viktimave nga këto kategori	Komuna ZPK Donatorët,	
	2.2 Ofrimin e mbështetjes ekonomike me fond të veçantë prej komunës	M+R AM			
	2.3 Ndarja e subvencioneve për familjet në zonën rurale	P+M+R AM			
	2.4 Përkrahje e strehimore "Shtëpia ime" për kryerjen e shërbimeve dhe mbështetjen e të mbijetuarave të DHF	M+R Aktivitet në vijimësi			3000 €
C.3. Zgjidhje afatmesme e strehimit për rastet e të mbijetuarave të DHF	3.1 Pagesa e qirasë për vendëstrehimin e viktimave të dhunës në familje	M+R Aktivitet në vijimësi		Komuna Donatorë	

C.4 Ttrajtimi i viktimave të dhunës në familje Mbështetja mjekesore dhe psikologjike e të mbijetuarve të dhunës në familje .	1. trajtimi me prioritet dhe privatesi të plotë (përpos rasteve emergjente) 2. Furnizimi me protokole dhe udhërrëfyes të trajtimit të dhunës në familje dhe furnizimi me medikamente të cilat mungojne nga lista esenciale falas ,mbështetja psikologjike e tyre			QKMF	300 €
---	---	--	--	------	-------

VII. Aranzhimet e zbatimit, monitorimit dhe raportimit

7.1. Shtrirja kohore e strategjisë

Synimi kryesorë i Komunës Kaçanikut , pa dyshim se është zbatimi në tërësi i dokumentit strategjikë, proces ky që do të përcaktohet nga realizimi i aktiviteteve dhe objektivave të përcaktuara në Planin e Veprimit nëpër vite. Procesi i zbatimit të strategjisë, do të jetë një proces i realizimit të synimeve strategjike dhe objektivave të saj.

Procesi i zbatimit të masave dhe politikave të parashikuara në Strategjinë Komunale kundër Dhunës në Familje kanë një shtrirje të kohë gjatësisë prej 5 viteve, që përfshin vitet 2021-2025. Ndërsa, për zbatimin e objektivave strategjike, hartohet Plani i Veprimit 3 vjeçarë në të cilat përcaktohen objektivat specifike, aktivitetet konkrete karshi institucioneve përgjegjëse dhe mbështetëse për zbatimin e tyre, treguesit SMART, gjendja ekzistuese, synimi/targeti, burimet financiare, të cilat duhet përlllogaritur duke iu referuar buxhetit të paraparë në kornizën/grandin komunal si dhe afatet kohore për përmbushjen e tyre. Gjithashtu, në përlllogaritjen e nevojave financiare duhet të merren në konsideratë edhe projektet me financim nga donatorët, në vijim ose të planifikuara, sipas fushave specifike.

Zyrtari/ja për Barazi Gjinore do të jetë përgjegjëse për koordinimin dhe bashkërendimin e punës përgjatë hartimit të Planit të Veprimit në bashkëpunim me të gjithë akterët relevantë. Obligohen të gjitha institucionet mandatore në nivel lokal, për zbatimin e objektivave dhe aktiviteteve të përcaktuara në Strategjinë dhe Planin e Veprimit kundër Dhunës në Familje. Po ashtu, institucionet përgjegjëse, departamentet komunale përkatëse, duhet të sigurojnë përfshirjen e politikave, aktiviteteve që burojnë nga strategjia në kuadër të planeve vjetore të punës së tyre.

Përderisa, monitorimi dhe vlerësimi i realizimit të objektivave dhe efektshmërisë së aktiviteteve përkatëse, janë pjesë integrale e strategjisë dhe komponentë kryesor e procesit të zbatimit të saj. Monitorimi dhe vlerësimi do të shërbejnë për të ndjekur ecurinë e strategjisë, për të matur në proces shkallën e realizimit të objektivave të saj, për të vlerësuar nevojën dhe përcaktuar drejtimit e rregullimeve, veçanërisht lidhur me aktivitetet. Procesi i monitorimit do të realizohet nga Mekanizmit Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në bashkëpunim me institucionet lokale përgjegjëse për zbatim të dokumentit strategjikë dhe me pjesëmarrjen e gjerë të organizatave jo qeveritare, strehimoreve dhe grupeve tjera të interesit.

Andaj, çdo fund vit, Zyrtari/ja për Barazi Gjinore në bashkëpunim me Mekanizmin Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, do të hartojnë raportin vjetorë i cili duhet të përmbajë vlerësimin e aktiviteteve më të suksesshme dhe në përgjithësi përmbushjen e qëllimeve të strategjisë, identifikimin e sfidave dhe vështirësive të hasura gjatë procesit të zbatimit si dhe ofrimin e rekomandimeve konkrete për mënjanimin e pengesave të paraqitura përgjatë procesit të

përmbushjes së objektivave specifike dhe atyre strategjike. Për monitorimin e zbatimit të dokumentit strategjikë dhe efektivitetit të saj janë esenciale:

- (i) për të siguruar që po arrihen qëllimet,
- (ii) për të monitoruar kontributet e investuara dhe aktivitetet,
- (iii) për të siguruar nëse implementimi po shkon sipas rrjedhës së përcaktuar,
- (iv) për të paralajmëruar institucionet përgjegjëse për problemet/ngecjet ose problemet potenciale para se situata të bëhet kritike,
- (v) për të sugjeruar veprime korrigjuese ose për të rishikuar strategjinë në bazë të përvojës së fituar.

Duke monitoruar strategjinë dhe indikatorët e performancës, Komuna e Kaçanikut do të jenë në gjendje të krijojnë një pasqyrë mbi gjendjen, d.m.th. në ç 'pikë ndodhet strategjia drejt arritjes së qëllimeve të përcaktuara, nxjerrjes së mësimave, marrjes së masave korrigjuese, dhe, nëse është e mundur, proceseve rishqyrtuese të saj

7.2. Mekanizmat zbatues

Të gjitha institucionet qeveritare lokale, obligohen të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për zbatimin të detyrimeve të përcaktuara në "Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje" nëpër vite, në përputhje me përgjegjësitë dhe mandatin ligjor të tyre.

Institucioni kryesor përgjegjës për zbatim të strategjisë është Komuna e Kaçanikut me dikasterët e saj (ZBGJ, QPS, QKMF, DKA), Policia e Kosovës, Prokuroria dhe Gjykatat Kshili i Bashkësis Islame .

Ndërsa si institucione që mund të i ndihmojnë në parandalimin e dhunës në familje, dhe mbrojtjen e viktimave, janë: Ekipa Vepruese për Siguri në Bashkësi – EVSB, Këshilli i Veprimit Rinor Lokal, OJQ-të.

Zyra për Punësim: Në koordinim me Qendrën për Punë Sociale, regjistron dhe evidenton personat, të cilët lajmërohen në zyrë, ndaj të cilëve është ushtruar dhunë në familje. Këtyre personave në cilësi të punëkërkesve, ju ofrohet: këshillim profesional, informim mbi mundësitë e punësimit, përgatitje dhe ndërmjetësim në punësim, informim për aftësim dhe riaftësim profesional me qëllim përgatitjen për nevojat e tregut të punës.

Mbrojtësi i viktimave i cili bashkëpunon ngushtë me institucionet e tjera që ofrojnë ndihmë për viktimat e Dhunës në Familje, dhe lloje të tjera të dhunës apo trafikimit me qenieve njerëzore, etj si Policinë, QPS, Prokurorinë, Gjykatën, QKMF, strehimoren, etj. Ndër detyrat e tij është të

informojë viktimën për të drejtat ligjore, të parapara sipas ligjeve në fuqi për dhunën në familje, të parapërgatitë viktimën për seancat gjyqësore, e shoqëron gjatë seancave si në Prokurori dhe Gjykatë, etj.

Zyra për Ndihmë Juridike falas: Kjo zyrë është në objektin e QPS, e cila gjendet në Kaçanik dhe ofron ndihmë juridike falas për viktimat e dhunës.

7.2. Mekanizmat monitorues dhe raportues

Sistemi i monitorimit dhe vlerësimit, do të shtrihet në të gjitha institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse për realizimin e objektivave të përcaktuara në Strategji si dhe aktiviteteteve që do të përcaktohen në Plan të Veprimit.

Për ta vlerësuar cilësinë dhe efektivitetin e ndërhyrjeve, apo anasjelltas, Mekanizmi Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje do të raportojnë përparimin në jetësimin e zbatimit të dokumentit strategjikë në baza vjetore.

ZBGJ (të përcaktohet kush sipas specifikave të Komunës) do të ketë rolin udhëheqës për të bashkërenduar punën, mbikëqyrur dhe vlerësuar procesin e zbatimit të Planit të Veprimit, në të njëjtën kohë do të shërbejë si Sekretariat, dhe në baza periodike çdo vit/6 muja do të raportojë direkt Kryetarit të Komunës. Me ç ‘rast, çdo fund vit Mekanizmi Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje është i obliguar të hartojnë “Raportin e Monitorimit” mbi zbatimin e dokumentit strategjikë, i cili do të jetë treguesi kyç për të pasqyruar qartë progresin apo regresin mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe aktiviteteteve të parapara në Planin e Veprimit. Ndërsa, varësisht nga rekomandimet e dala nga “Raporti i Progresit”, institucionet përgjegjëse janë të obliguara të shqyrtojnë dhe të zbatojnë ato në bazë sa më optimale të mundshme.

Njëkohësisht, institucionet qeveritare në nivel lokal, do të raportojnë në bazë të nevojave dhe kërkesës të drejtuar nga ZBGJ (të përcaktohet kush sipas specifikave të Komunës), në mënyrë që raportet institucionale të jenë të unifikuara dhe gjithëpërfshirëse.

Organizatat jo-qeveritare, inkurajohen që në partneritet me institucionet qeveritare të marrin pjesë në zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e dokumentit strategjikë.

Në çdo nismë të realizuar nga institucionet shtetërore, shoqëria civile dhe OJQ-të do të inkurajohen të paraqesin edhe raportet e tyre vëzhguese mbi zbatueshmërinë e dokumentit strategjikë apo raportet e tyre mbi aktivitetet e realizuara që lidhen me projektet dhe programet për realizimin e të drejtave të fëmijëve.

Koordinator i mekanizmit kundër dhunës në familje

z. Vedat Dema

